



---

# RAPORTI VJETOR

**2021**



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

## **RAPORTI VJETOR 2021**

Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 248 360 – Fax: +383 38 247 103

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org

## DORËZIMI I RAPORTIT VJETOR NË BORDIN MBIKËQYRËS TË NJIF-K

---

31 Gusht 2022

I nderuar z.Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K

Të nderuar anëtar të Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K,

Kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin vjetor për vitin 2021, ku përvijohen aktivitetet e Njesisë për Inteligjencë Financiare (NJIF-K) në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Raporti Vjetor për vitin 2021 dorëzohet në përputhje me nenin 10(1) të Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

NjIF-K ka pasur një vit sfidues dhe të ngarkuar, por edhe efektiv në menaxhimin e të gjitha aspekteve të kërkimit, marrjes, analizimit dhe shpërndarjes së informatave tek autoritetet kompetente lidhur me aktivitetet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

NjIF-K i shtoi vlerë të prekshme informacionit të pranuar, analizoi dhe shpërndau gjatë vitit rezultatet e analizave dhe arriti rezultate të shumta gjatë vitit 2021, duke përfshirë ndihmën e agjencive partnere në rikthimin e pasurive përmes ngrirjes së përkohshme të transaksioneve për të siguruar bashkëpunim optimal ndërmjet agjencive. NJIF-K ka qenë proaktiv në ndërtimin e partneriteteve publiko-private me bankat, si dhe të gjitha subjektet e tjera raportuese, për të siguruar përgjigje kthyesë e bashkëpunim optimal me sektorin privat në zbulimin e pastrimit të parave.

Janë ndërmarrë përpjekje për të përmirësuar rezultatet e Kosovës në pastrimin e parave dhe për të përfaqësuar NjIF-në para NjIF-ve të huaja si partnere e besueshme e profesionale.

Sinqerisht,

Behar Xhema

Ushtrues Detyre/Drejtorit, Njësia për Inteligjencë Financiare

<b>HYRJE</b> .....	5
<b>AKTIVITETET KRYESORE</b> .....	6
<b>REZULTATET KRYESORE TË PUNËS SË NJIF-K 2021</b> .....	7
<b>KAPITULLI I - LUFTIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT</b> .....	8
<b>POLITIKAT DHE KOORDINIMI VENDOR PËR PPP/LFT-NË</b> .....	9
<b>ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT</b> .....	13
<b>KAPITULLI II - MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E RAPORTEVE DHE INFORMACIONIT FINANCIAR</b> .....	15
<b>A. ANALIZA DHE MONITORIMI</b> .....	16
<b>B. SHPALOSJA, SHPËRNDARJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT</b> .....	24
<b>C. NGRIRJA E TRANSAKSIONEVE BANKARE DHE SANKSIONET</b> .....	27
<b>KAPITULLI III - MBIKËQYRJA E PAJTUESHMËRISË</b> .....	28
<b>MBIKËQYRJA E BAZUAR NË RREZIK</b> .....	29
<b>KAPITULLI IV - VLERËSIMI I RREZIKUT KOMBËTAR (VRK)</b> .....	36
<b>KAPITULLI V - TIPOLOGJITË SEKTORIALE</b> .....	38
<b>KAPITULLI VI - BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....	44
<b>BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI VENDOR</b> .....	45
<b>BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR</b> .....	47
<b>MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE</b> .....	53
<b>KAPITULLI VII - BUXHETI, FORCIMI I KAPACITETEVE</b> .....	57
<b>BUXHETI DHE PROKURIMI</b> .....	58
<b>TEKNOLOGJIA INFORMATIVE</b> .....	61
<b>KAPITULLI VIII - PRIORITETET STRATEGJIKE</b> .....	62
<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	66
<b>Shtojca 1</b> .....	68

# HYRJE

Në përputhje me mandatin e saj ligjor të përcaktuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF-K) paraqet Raportin Vjetor për vitin 2021.

Ky raport, përmban një pasqyrë të përmbledhur të aktiviteteve të agjencionit, duke evidentuar zhvillimet kryesore në lidhje me analizën operacionale, mbikëqyrjen e pajtueshmërisë, bashkëpunimin ndër-institucional dhe ngritjen e partneritetit publik-privat dhe atë në nivel ndërkombëtar, kapacitetet profesionale dhe teknike.

Plani i performancës dhe resurseve të NJIF-K 2021 përgjithësisht është zbatuar sipas afateve kohore, duke arritur përmbushjen e objektivave bazuar në indikatorët e performancës dhe tejkaluar indikatorët kyq të performancës për 9.82%

Zhvillimet më të rëndësishme në zhvillimin dhe përforcimin e politikave dhe koordinimi vendor për PPP/LFT-në konsistojnë në hartimin e planit të veprimit të vlerësimit të rrezikut kombëtar për PP/FT, inicimin e legjislacionit të pronësisë përfituese, zhvillimin e legjislacionit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare financiare të shënjestruara.

Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe masat parandaluese kanë shënuar progres të theksuar gjatë vitit 2021, duke promovuar dhe zhvilluar partneritetin publiko-privat dhe fuqizuar udhëzuesit dhe manualët për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik. Janë hartuar dhe publikuar Tipologjitë e pastrimit të parave.

Përmirësimi i aftësive të brendshme të NJIF-it për operativë dhe analiza ka shënuar progresin më të lartë në 10 vitet e fundit. Janë arritur si kurrë më parë të identifikohen dhe gjurmohen transaksione dhe fonde të cilat janë ngrirë nga NJIF-K në vlerë totale prej rreth 9 milion euro. Numri i raporteve të inteligjencës të shpërndarë tek autoritet tjera është ngritur për 28% krahasuar me vitin paraprak. Shkëmbimi vendor dhe ndërkombëtar i informacionit ka shënuar ngritje prej 8% përkatësisht 19% krahasuar me vitin paraprak.

Janë shënuar rezultate konkrete në zhvillimin dhe aplikimin e qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar. Tipologjia e Kosovës e prezantuar në Egmont Group është renditur në mesin e rasteve më të mira të publikuara në vitet 2014-2020.

# AKTIVITETET KRYESORE

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit është bërë temë fokusimi në rritje dhe shqetësim i madh për bashkësinë ndërkombëtare. Megjithëse shtetet gjithmonë janë shqetësuar për kërcënimet e bëra nga të ardhurat e pastruara të krimit, ky është bërë shqetësim i madh politik, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kosova është vlerësuar se ka bërë progres të theksuar në fuqizimin e mekanizmave ligjor për luftë sa më efektive të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Luftimi efektiv i këtyre dukurive mbetet njëra ndër sfidat e vendit tonë drejt krijimit të një regjimi sa më efektiv të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për afrim me standardet ndërkombëtare. NJIF-K bën përpjekje që legjislacioni të jetë në harmoni të plotë me Direktivat e BE si dhe standardet ndërkombëtare të FATF. NJIF-K dhe autoritetet tjera janë duke bërë përpjekje për zhvillimin e një sistemi efikas të sanksioneve financiare të shënjestruara dhe masave që të arrihet privimi i plotë i aseteve.

# REZULTATET KRYESORE TË PUNËS SË NJIF-K 2021



## Inteligjenca Financiare

Në vitin 2021, 203 raporte të inteligjencës u referuan agjencive të zbatimit të ligjit krahasuar me 158 raporte në 2020.

## Koordinimi Kombëtar

Zhvillimi i Planit të Veprimit për adresimin e të gjeturave të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të PP/FT.



## Pronësia Përfituese



Është iniciuar hartimi i legjislacionit për ndërtimin e regjistrin nacional të pronësisë përfituese, si dhe NJIF-K ka nxjerrë udhëzime administrativ për pronarin përfitues .

## Zhvillimet Ligjore

Inicimi i plotësimit ndryshim të Ligjit për PPP/LFT si dhe hartimi i Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara. Për më tepër është iniciuar ligji për regjistrin e pronësisë përfituese



## Ngrirja e fondeve/transaksioneve



Vlera e transaksioneve fondeve të ngrira nga NJIF-K në vitin 2021 ka shënuar ngritje të theksuar krahasuar me vitet paraprake. Rreth 9 milion euro janë ngrirë transaksione të dyshuara për PP/FT.

## Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Në vitin 2021, NJIF-K shkëmbeu me partnerët ndërkombëtar 137 informacione të inteligjencës financiare apo 19% më tepër se vitin paraprak (115: 2020).



## KAPITULLI I - LUFTIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Raporti i Vlerësimit të Përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit i bërë në muajin dhjetor të vitit 2018 nga ekspertët e Këshillit të Evropës në kuadër të Projektit kundër Krimit Ekonomik (PECK II), sipas metodologjisë së vlerësimit të MONEYVAL, ka paraqitur rekomandimet kryesore lidhur me veprimet që duhen të ndërmerren nga institucionet e Kosovës me qëllim të adresimit të tyre.

Njësia për Inteligjencë Financiare në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe përgatitjet në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian është në proces të përmbushjes së obligimeve që dalin ky plan kombëtar. Në kuadër të realizimit me sukses të aktiviteteve të saj i jep prioritet të lartë gjitha obligimeve të marra në raport me Komisionin Evropian në Agjendën e Reformave Evropiane.

Po ashtu, Raporti i Progresit i BE për vendin për vitin 2021, thekson nevojën e avancimit të Ligji për Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, pasi ende nuk është plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, si dhe ndërmarrjen e disa veprimeve me qëllim të adresimit të rekomandimeve të dala nga Raporti i Vlerësimit të Përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit.



## **POLITIKAT DHE KOORDINIMI VENDOR PËR PPP/LFT-NË**

Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K kryen funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e Ligjit për PPP/LFT.

Qeveria e Republikës së Kosovës, ka aprovuar Planin e Veprimit të rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/ Luftimin e Financimit të Terrorizmit (efektiviteti) si dhe shtojca 1 (Pjesa Teknike), Shtojca 2 (Udhëzues për Zbatimin e Mjetit për Monitorimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit), Shtojca 3 (Mjet për Monitorimin e Zbatimit të Rekomandimeve nga Raporti i Vlerësimit).

Njësia për Inteligjencë Financiare është e caktuar të bëjë monitorimin e duhur të zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit për të mundësuar që të rishikoj efektivitetin e sistemit Kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me neni 14 të Ligjit Nr. 05/L - 096 për PPP/LFT, si dhe me këtë vendim është krijuar edhe grupi i punës për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore për parandalimin e pastrimit të parave, luftimin e financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioriteteve afatgjata dhe afatshkurta.

Mekanizmat tjerë shtetëror koordinues në fushën e PPP/LFT-së janë si në vijim:

- Grupi punues për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për PP/FT;
- Sekretariati i Grupit Punues Qeveritar të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare;

- Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

## **VEPRIMET E NDËRMARRA PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË LPP/LFT-së**


Kosova mbetet e përkushtuar në fuqizimin e mekanizmave ligjor e institucional për luftë sa më efektive të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Luftimi efektiv i këtyre dukurive mbetet njëra ndër sfidat e vendit tonë drejt rrugëtimit për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare dhe përafrim me standardet ndërkombëtare.

NJIF-K në fillim të vitit 2021, ka themeluar Grupin Punues për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e politikave afatgjata dhe afatshkurtra. Ky Grupi Punues përbëhet nga autoritet si në vijim:

- Njësia për Inteligjencë Financiare (koordinatore e grupit punues)
- Ministria e Financave
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/ ARBK
- Këshilli Prokurorial i Kosovës & Prokuroria e Shtetit & PSRK
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
- Policia e Kosovës
- Administrata Tatimore e Kosovës
- Dogana e Kosovës
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Në punimet e grupit punues mund të marrin pjesë edhe zyrtarë të tjerë të institucioneve të Republikës së Kosovës apo institucioneve tjera, të cilët Kryesuesi në koordinim me anëtarët e Grupit Punues i konsideron të nevojshëm.

## Implementimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit i rekomanduar për përmirësimin e sistemit të LPP/LFT-së dhe mjetit të monitorimit



Zbatimi i Planit të Veprimit të rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/ Luftimin e Financimit të Terrorizmit (efektiviteti) është bazuar në mjetin e monitorimit. Është udhërrëfyes që duhet të përcjellët në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike.

Planin e Veprimit përmban mekanizmat e monitorimit dhe rishikimit për të siguruar zbatim efikas të objektivave strategjike dhe aktiviteteve të definuara në Planin e Veprimit.

Planin e Veprimit përfshin gjithsej **87 veprimet e rekomanduara**. Për sa i përket llojit të masës (që duhet të merren) për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit klasifikohen si:

- *Legjislative* (L) - përmban 23 veprime të rekomanduara që duhet të ndërmerren. Këto janë masa që lidhen me rishikimin e bazës ligjore ekzistuese të kërkesave për institucionet financiare dhe DNFBP të përcaktuara me ligj ose me mjete të zbatueshme.;

- *Institucionale (I)* - përmban 16 veprime të rekomanduara që duhet të ndërmerren. Këto janë masa që lidhen me rishikimin e modelimit, strukturës dhe përbërjes së strukturës institucionale ekzistuese brenda agjencive të ndryshme të interesit dhe organeve të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së financimit. ;
- *Operative (O)* - përmban 34 veprime të rekomanduara që duhet të ndërmerren. Këto janë masa që lidhen me rishikimin e mjeteve ekzistuese operative <sup>1</sup>, mjeteve jo të zbatueshme<sup>2</sup>, si dhe praktikat dhe aktivitetet përkatëse të autoriteteve kompetente dhe subjekteve të detyruara; ose
- *Mbështetëse (S)* - përmban 14 veprime të rekomanduara që duhet të ndërmerren. Këto janë masa që lidhen me aktivitetet<sup>3</sup> që synojnë ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme midis autoriteteve kompetente dhe subjekteve të detyruara.

Në aspektin e statusit të implementimit, autoritet e vendit kanë ndërmarrë masa për ta përmirësuar pajtueshmërinë teknike dhe efektivitetin e kornizës së saj LPP/LFT. Në të njëjtën kohë, një numër i boshllëqeve duhet të adresohen. Bazuar në mjetin për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raportit të vlerësimit, rezultatet tregojnë se në aspektin e statusit të implementimit:

<b>Numri total i masave</b>	<b>87</b>
<i>Nga të cilat, në aspektin e statusit të implementimit:</i>	
Kompletuar (C)	19
Në proces (I)	46
I pa iniciuar (N)	4
në vazhdimësi (R)	18


Për sa i përket llojit të masës sipas prioritetit, ato janë kategorizuar si në vijim:

<sup>1</sup> Sic janë procedurat standarde, manuale dhe metodologji

<sup>2</sup> Sic janë udhëzues, kode të mirësjelljes ose akte të brendshme

<sup>3</sup> Sic janë trajnime, ngritje të vetëdijlsimit ose konsulenca

- *Urgjente (U)* - përmban gjithsej 11 rekomandime të cilat tregojnë që masa përkatëse duhet të zbatohet si çështje urgjente për shkak të ndikimit themelor të boshllëkut përkatës ose mangësisë në efektivitetin e sistemit PPP / LFT;
- *E lartë (H)* - përmban gjithsej 37 rekomandime të cilat tregojnë që masa përkatëse është me përparësi të lartë për sa i përket funksionimit efektiv të sistemit PPP / LFT dhe, kur është e përshtatshme, zbatimi i saj duhet të përfundojë brenda një periudhe afatshkurtër (p.sh. 3-6 muaj);
- *E mesme (M)* - përmban gjithsej 32 rekomandime të cilat tregojnë që masa përkatëse është me përparësi mesatare për sa i përket funksionimit efektiv të sistemit PPP / LFT dhe, kur është e përshtatshme, zbatimi i saj mund të përfundojë brenda periudhës afatmesme (p.sh. 7-18 muaj); ose
- *E ulët (L)* - përmban gjithsej 7 rekomandime të cilat tregojnë që masa përkatëse është me përparësi të ulët për sa i përket funksionimit efektiv të sistemit PPP / LFT dhe, kur është e përshtatshme, zbatimi i saj mund të përfundojë brenda një periudhe afatgjatë (psh. 19-36 muaj).



Grafiku 1: Statusi i implementimit të rekomandimeve të raportit të vlerësimit të CoE



## ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

Kosova është vlerësuar se ka bërë progres të theksuar në fuqizimin e mekanizmave ligjor për luftë sa më efektive të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Luftimi efektiv i këtyre dukurive mbetet njëra ndër sfidat e vendit tonë drejt krijimit të një regjimi sa më efektiv të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përafrim me standardet ndërkombëtare. NJIF-K bën përpjekje që legjislacioni të jetë në harmoni të plotë me "acquis" dhe Direktivat e BE si dhe standardet ndërkombëtare të FATF. NJIF-K dhe autoritetet tjera janë duke bërë përpjekje për zhvillimin e një sistemi efikas të sanksioneve financiare të shënjestruara dhe masave që të arrihet privimi i plotë i aseteve.

## ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

Përgjatë vitit 2021, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës ka vazhduar punën sa i përket përafrimit të legjislacionit me standardet ndërkombëtare të FATF-së dhe Direktivat e Bashkimit Evropian.

Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për trajtimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave (PPP) dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LFT) ka bërë rishqyrtimin e kompetencës ekskluzive të Prokurorisë Speciale mbi ndjekjen penale të pastrimit të parave.

Koncept Dokumenti për trajtimin e legjislacionit në fushën e PPP/LFT synon të adresojë rekomandimet e dala nga Raporti i Vlerësimit të Përputhshmërisë me Standardet Ndërkombëtare të PPP/LFT i bërë nga ekspertët e Këshillit të Evropës në kuadër të Projektit kundër Krimit Ekonomik (PECK II), sipas metodologjisë së vlerësimit të MONEYVAL.

Ky Koncept Dokument po ashtu synon të adresoj gjetjet kyçe në raport me përputhshmërinë teknike të legjislacionit të Kosovës me Direktivën 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 20 maj 2015 për Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për qëllime të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit e ndryshuar nga Direktiva (BE) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018.

Po ashtu, NjIF-K ka pasur angazhim të vazhdueshëm duke dhënë kontribut kryesor në kuadër të Grupit Punues të formuar nga MPJD për hartimin e Draft Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, ku me miratimin e tij pritet të kemi një avancim sa i përket pajtueshmërisë së Kosovës në fushën e PPP/LFT me rekomandimin 6 (sanksionet specifike

financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit) dhe rekomandimin 7 (sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë) të FATF.

Përpyekjet e vendit në forcimin e legjislacionit Kombëtar për PPP/LFT kanë vazhduar tutje për të qenë në harmoni me standardet ndërkombëtare. NjIF-K ka mbështetur Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për inicimin e hartimit të legjislacionit për regjistrin e pronësisë përfituese. Është hartuar Koncept Dokumenti i cili synon të trajtoj dhe sqaroj kërkesat ndërkombëtare si të rekomandimeve të FATF ashtu edhe të EU 5AMLD dhe siç kërkohet nga këto standarde, vendi duhet të sigurojë një qasje më të lehtë dhe më të mirë, në një mënyrë mjaft koherente dhe të koordinuar, në informacionin në lidhje me pronësinë përfituese të personave juridikë dhe marrëveshjeve ligjore nga autoriteteve kompetente dhe subjekteve raportuese, të cilat janë të detyrueshme sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e pronarëve përfitues të këtyre personave juridikë dhe marrëveshjeve tjera ligjore.

Për më tepër me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të infrastrukturës ligjore (legjislacionit sekondar) dhe ofrimi i udhëzimeve për subjektet raportuese, gjatë vitit 2021 janë miratuar aktet nënligjore si në vijim:

### Udhëzim Administrativ për Pronarin Përfitues

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës me datë 26/07/2021 ka miratuar dhe publikuar Udhëzimin Administrativ MF (NjIF-K) Nr. 01/2021 për Pronarin Përfitues për Subjektet Raportuese me qëllimi të rritjes së transparencës së pronësisë përfituese, si dhe udhëzimit të subjekteve raportuese të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 05/L-096

për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, për identifikimin dhe verifikimin e pronarëve përfitues me qëllim të menaxhimit me efektivitet të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ky udhëzim përveç tjerash ofron edhe shembuj praktik për nivelet e kontrollit të pronësisë përfituese përmes qasjes në tri nivele siç janë kontrolli përmes pronësisë, kontrolli përmes mjeteve tjera dhe kontrolli përmes pozitës së lartë menaxhuese.

### **Udhëzues për subjektet raportuese për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe rreziqet e PP/ FT që ndërlidhen me COVID-19**

Ky udhëzues paraqet një përmbledhje të shkurtër të rreziqeve të PP/FT që ndërlidhen me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, ndikimit që ato kanë në aktivitetin parandalues dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese, për zvogëlimin dhe zbutjen efektive të tyre.

### **Rregullore e brendshme nr. 01/2021 për politikën dhe procedurat e teknologjisë informative në Njësinë Për Inteligjencë Financiare**

Qëllimi i kësaj rregullore të brendshme është që të mundësoj organizimin e Sistemit të Teknologjisë Informative në NJIF-K, të siguroj funksionalitetin e sistemeve të TI-së, ruajtjen e performancës së rrjeteve, garantoj imazhin e NJIF-K, qasjen dhe frekuentimin e punonjësve në këto sisteme dhe në veçanti garantimi i sigurisë, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave. Kjo rregullore e brendshme mbulon përdorimin dhe monitorimin e pajisjeve dhe sistemeve të TI-së, ruajtjen e të dhënave, krijimin dhe funksionimin e llogarive elektronike zyrtare dhe profesionale, qasjes në

rrjetën të sigurt dhe internet dhe aspekte të tjera të cilat lidhen me sistemin e TI-së së NJIF-K.

Njësia për Inteligjencë Financiare në përputhje me pikën B të Udhëzuesit me nr. FIUAD:70/2018, ka vazhdua me publikimin e listës së përditësuar në muajin Tetor 2021 të Juridiksioneve me Rrezik të Lartë që i nënshtrohen një Thirrjeje për Veprim si dhe Juridiksionet nën Monitorim të Rritur të përcaktuara nga FATF.

### **Ofrimi i opinioneve ligjore në zbatimin të ligjit për PPP/LFT**

Ofrimi i opinioneve të lëshuara nga NJIF-K për subjektet raportuese dhe institucionet tjera, ka qenë një nga aktivitetet e NJIF-K që ka synuar ofrimin e udhëzimeve për subjektet raportuese. Gjithsej 15 opinione dhe sqarime këshilluese janë lëshuar gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2021, po ashtu është punuar edhe në hartimin e akteve nënligjore si në vijim, të cilat pritet të miratohen gjatë vitit 2022:

- Udhëzim Administrativ për Subjektet Raportuese për Raportimin e RAD-ve
- Udhëzues për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik;
- Udhëzim Administrative për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit;
- Udhëzim Administrativ për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave;
- Udhëzues për faktorët e rrezikut;
- Udhëzues për Analizë Strategjike;
- Procedura Standarde e Operimit për Shpërndarjen dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet NJIF-K-së dhe autoriteteve kompetente;
- Procedurën Standarde të Operimit për Ngrirjen e Transaksionit.

## KAPITULLI II - MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E RAPORTEVE DHE INFORMACIONIT FINANCIAR

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit janë probleme globale që kërcënojnë sigurinë dhe stabilitetin e institucioneve dhe sistemeve financiare, minojnë prosperitetin ekonomik dhe dobësojnë sistemet e qeverisjes.

Në mbarë botën, Njësitë e Inteligjencës Financiare (FIU) luajnë një rol udhëheqës në parandalimin e aktiviteteve kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (LPP/LFT). Ata janë përgjegjës për marrjen, përpunimin dhe analizimin e raporteve të bëra nga institucionet financiare ose subjekte të tjera në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve vendase LPP/LFT. Raporte të tilla dhe informacione të tjera të mbledhura nga NjIF-të shpesh ofrojnë bazën për hetime mbi pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe vepra të tjera të rënda.

## A. ANALIZA DHE MONITORIMI

### Të dhënat dhe raportet e proceduara

Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës vepron si autoritet kompetent, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

*NjIF mbetet e përkushtuar për të kontribuar në çështjet vendore dhe programet globale të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke zhvilluar politikat dhe përforcuar rrjetet e shkëmbimit të informacionit.*

Detyrat dhe kompetencat e NjIF-K janë të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet e mbledhura nga një gamë e gjerë e subjekteve të rregulluara. Ky informacion përpunohet dhe analizohet në lidhje me një sërë burimesh të tjera informacioni për të prodhuar inteligjencë financiare në linjë me rreziqet dhe kërcënimet kryesore të përcaktuara në vlerësimin e rrezikut kombëtar dhe kundër sigurisë kombëtare të vendit.

Për më tepër, NjIF-K merr dhe analizon informacionet që i janë ofruar NjIF-K-së nga NjIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare; dhe që i janë ofruar vullnetarisht NjIF-K-së në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe/ose financimit të terrorizmit.

Aftësia e NjIF-K për të menaxhuar dhe përdorur të dhënat e ofruara nga subjektet e detyruara dhe partnerë të tjerë është kritike për performancën tonë dhe vlerën e inteligjencës sonë. Kritika e aktiviteteve të pastrimit të parave dhe financimit të

terrorizmit në nivel global kërkon mbledhjen e informacionit më të detajuar, kërkimin e burimeve të reja të të dhënave dhe zhvillimin e mjeteve të avancuara për të analizuar dhe lidhur shpejt informacionin me volumin e lartë dhe me shumëllojshmëri të madhe.

NjIF-K është e autorizuar të grumbullojë informacione që kanë lidhje me aktivitetet e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura penale ose financimin e aktiviteteve terroriste dhe që është në dispozicion publik, përfshirë bazën e të dhënave komerciale në dispozicion.

NjIF-i është e autorizuar të mbledhë informata shtesë nga të gjitha subjektet raportuese (pavarësisht nga subjekti që ka paraqitur raportin) sa herë që një rast hapet për analizë dhe kjo mund të bëhet duke u bazuar në një numër të madh shkaktarësh.

Bazuar në mandatin e saj ligjor, NjIF-K mund të kërkojë nga organet publike ose qeveritare të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ligji dhe të ketë qasje në bazat e të dhënave të cilat mbahen nga këto organe.




Zhvillimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për të gjitha informacionet e mbledhura ose të pranuar në lidhje me dyshimin për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale ose financimin e terrorizmit si dhe materiale të tjera të ngjashme relevante për punën e NjIF-K, mbesin ndër prioritetet e rëndësishme të saj strategjike.

Në vitin 2021, NjIF-K regjistroi gjithsej 12,656 raporte të cilat janë proceduar në sistemin



elektronik të përpunimit të të dhënave. Këto raporte konsistojnë në:

- raporte të transaksioneve apo aktiviteteve të dyshimta për pastrim të parave (STR/SAR);
- raporte të transaksioneve apo aktiviteteve të dyshimta për financim të terrorizmit (TFR),
- raportet e transaksioneve në para të gatshme (CTR);
- raporte të informacioneve shtesë (AIF), raportet e deklarimit kufitar (BCR),
- raportet e informatave kthyesë (FDR), urdhrat e ngrirjes së përkohshme të transaksioneve (FRZ),
- raportet e inspektimeve (INR),
- kërkesat e shkëmbimit të informacionit vendor dhe ndërkombëtar (IRD/IRI), kërkesat për subjektet raportuese/organet publike dhe ndërkombëtare (ORD/ORI).



Grafiku 2: Dinamika e raporteve të proceduara në vitet 2017-2021

Numri i të dhënave dhe raporteve të proceduara					
Lloji i Raportit	2017	2018	2019	2020	2021
AIF	3,718	3,222	3,337	3,503	3,266
CTR	2,177	2,464	2,633	2,563	2,629
BCR	1,108	1,212	969	786	1,766
FDR	68	19	16	60	23
FRZ	3	4	3	31	46
INR	17	14	25	31	31
IRD	125	156	175	185	200
IRI	33	32	26	32	43
ORD	1,008	2,033	2,754	2,498	3,677
ORI	35	62	74	42	55
STR (PP)	704	639	997	896	914
TFR	7	5	7	6	6
UTR	52	143	0	0	0
<b>Gjithsej:</b>	<b>9,055</b>	<b>10,005</b>	<b>11,016</b>	<b>10,633</b>	<b>12,656</b>


Tabela 1: Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2016-2021

## Raportet e Transaksioneve/Aktiviteve të Dyshimta (RTD/RAD)

**Akt ose Transaksion i Dyshimtë** - një akt ose transaksion ose një akt ose transaksion i tentuar, që krijon dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit.

Subjektet raportuese të përcaktuara në nenin 16 të Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit janë të obliguara sipas nenit 26 të këtij ligji të raportojnë tek NjIF-K, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NjIF-K të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.

NjIF-K ka pranuar 920 RTD/RAD në 2021 ose mesatarisht 77 RTD/RAD në muaj. Kjo pasqyron një ngritje të raportimit prej 2 % krahasuar me 902 RTD/RAD të raportuara në 2020.




Grafiku 3: Numri i RTD-ve të raportuara 2017-2021

Bankat dhe Institucionet Financiare përbëjnë numrin më të lartë të RTD-ve (95%) në krahasim me sektorët tjerë si BPCJT-të.

Nga gjithsej RTD/RAD e pranuar në vitin 2021, 81% e tyre janë trajtuar brenda këtij viti, krahasuar me 70% në vitin 2020. Kjo pasqyron një ngritje prej 11% të trajtimit të RTD/RAD-ve me vitin paraprak, gjë që reflekton ngrije të efektivitetit në trajtimin e raporteve të dyshimta të pranuar gjatë vitit 2021. Përderisa 19% e RTD/RAD-ve të pranuar në vitin 2021 janë bartur për t'u trajtuar në vitin pasues 2022.

Treguesi Kyç   Performancës	Gjithsej RTD 2021	%
Numri i raporteve të marra mbi transaksionet e dyshimta PP (RTD)	725	79%
Numri i raporteve të marra mbi aktivitetet e dyshimta PP (RAD)	189	21%
Numri i raporteve të marra mbi dyshimin e financimit të terrorizmit TFR	6	1%
<b>Gjithsej RTD/RAD/TRF të pranuar 2021</b>	<b>920</b>	<b>100.00%</b>
<b>Rezultatet e analizave të RTD/RAD/TRF-ve</b>		
Procedimi i STR-ve/SAR/TFR për t'u analizuar (open CAP&CAS)	595	65%
STR/SAR/TFR bashkangjitur rasteve ne proces	116	13%
Arkivim i STR/SAR/TFR	30	3%
<b>Gjithsej RTD/RAD/TRF të trajtuar (analiza paraprake) 2021</b>	<b>741</b>	<b>81%</b>
RTD/RAD/TFR ne shqyrtim	179	19%
<b>Gjithsej</b>	<b>920</b>	<b>100.00%</b>

Tabela 2: Treguesit kyç të performancës në trajtimin e RTD/RAD/TRF 2021




Grafiku 4: Raporti i trajtimit të RTD-ve 2021

Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2017-2021					
Subjektet Raportuese	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Bankat dhe Institucionet Financiare</b>					
Bankat	683	559	785	710	661
Institucionet Mikrofinanciare	5	10	17	13	27
Sektori i sigurimeve	-	2	5	1	1
Këmbimoret (Këmbimi i parave dhe monedhave)	-	-	-	-	-
Agjensionet për Transfer Parash	34	33	137	149	182
Leasing	-	-	3	5	6
Sektori i letrave me vlerë	-	-	-	-	-
Institucionet tjera Financiare	-	-	-	-	-
<b>BPCJF-të</b>					
Agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme	-	-	-	-	-
Avokatët	-	2	1	1	2
Noterët	-	37	76	17	34
Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor	-	-	1	-	-
Auditorët e licencuar	-	-	-	-	-
Trustet dhe ofruesit e shërbimeve për kompanitë	-	-	-	-	-
Organizatata Jo-Qeveritare	-	-	-	-	-
Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar	-	-	-	-	-
Personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë	-	-	-	3	-
Profesionistë të tjerë	-	-	-	-	-
<b>Mbikëqyrësit dhe institucionet tjera</b>					
Dogana e Kosovës	-	1	-	1	-
Mbikëqyrësit sektorial	4	-	1	-	2
Tjera	2	-	1	2	5
<b>Gjithsej RTD-të e raportuar 2017-2021</b>	<b>728</b>	<b>644</b>	<b>1027</b>	<b>902</b>	<b>920</b>

Tabela 3: Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2017-2021

## Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

NjJIF-K ka pranuar 2,629 raporte në para të gatshme me gjithsej 969,524 transaksione (RTG) në 2021 ose mesatarisht rreth 80,793 RTG në muaj. Kjo është një ngritje prej 33% krahasuar me 730,854 RTG të raportuara në NJJIF-K në vitin 2020.



Grafiku 5: Numri i RTG-ve të pranuar 2017-2021

Gjatë viteve të fundit ka filluar raportimi i RTG-ve edhe nga tregtarët me vlera të larta. Kjo kategori kryesisht përbëhet nga dy lloje të subjekteve: 1) Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar (TMGÇ) dhe 2) tregtarët apo shitësit e makinave, posaçërisht të makinave të shtrenjta/luksoze.

## Raportimi i Deklarimit Kufitar (BCR)

Në vitin 2021, NJJIF-K ka pranuar 1776 BCR. Kjo tregon një ngritje prej 125% krahasuar me 786 BCR të pranuar në 2020. Kjo ngritje e deklarimeve si në hyrje ashtu edhe në dalje kufitare ishte në përpjesëtim me ngritjen dhe lehtësimin e udhëtimeve gjatë pjesës së dytë të vitit 2021, duke qenë se viti 2020 kishte kufizime dhe masa restriktive në udhëtim.

Sipas nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT, secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart instrumente monetare në vlerën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë, apo vlerën

ekuivalente në valutë të huaj duhet të deklarojnë tek Dogana e Kosovës, para zyrtarit doganor.

Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare			
Numri i Raporteve të deklaruara			
Vitet	Personat Juridik	Personat Fizik	Numri i deklarimit te RTG-ve
1	2	3	4 = (2+3)
2021	1388	388	1776
2020	554	232	786
2019	650	319	969
2018	816	396	1,212
2017	664	444	1,108
2016	732	424	1,156
2015	606	658	1,264
2014	667	583	1,250
<b>Gjithsej</b>	<b>1,388</b>	<b>3,444</b>	<b>9,521</b>

Tabela 4: Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2014-2021

NJJIF-K mbështet plotësisht Doganën e Kosovës në përpjekjet e tyre të zellshme për të identifikuar individët që shkelin obligimin e deklarimit si në hyrje ashtu edhe në dalje nga vendi. NJJIF-K siguron që çdo informacion që ka në posedim të inteligjencës financiare dhe që ka të bëjë ndaj shkeljeve të mundshme të mos deklarimeve, shpërndanë raporte të tilla në Doganë për ushtrim të kontroleve në përputhje me rrethanat. NJJIF mbështet gjithashtu Doganën dhe autoritet tjera me çfarëdo rreziku të identifikuar gjatë vlerësimit të rreziqeve dhe analizave strategjike të zhvilluara, përfshirë edhe informacionin për korrierët e mundshëm të parave të gatshme që barten përmes pikave kufitare.



Kosova ka zbatuar një sistem të deklarimit në pajtim me nenin 33 të Ligjit për PPP/LFT-në. Përkufizimi i nenit 2, paragrafi 1.17 për instrumentet monetare që duhen deklaruar është mjaft i gjerë sa për të përfshirë të gjitha instrumentet e kërkuara sipas përkufizimit të fjalorit në Rekomandimet e FATF-së. Regjimi i deklarimit zbatohet për çdo person që hyn ose del nga Kosova, si dhe për çdo person që dërgon ose pranon instrumente monetare me anë të postës, dërgesave të mallrave ose korrierëve tregtarë. Pragu është vendosur në 10.000 euro ose më shumë.

Sipas paragrafit 7 të nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT-në, DK-ja ka fuqinë të konfiskojë instrumentet

monetare në kufi që dyshohet se janë të ardhura nga krimi. Kjo duhet t'i njoftohet menjëherë Prokurorit për hetim. DK-ja gjithashtu duhet të informojë NjIF-in. Gjithashtu ndaj personit i cili nuk respekton dispozitat e deklarimit sipas ligjit, kryen vepër të kundërvajtjes që dënohet me gjobë prej njëzet e pesë përqind (25 %) të shumës totale të instrumenteve monetare në posedim për të cilat ka detyrim për të deklaruar..

Statistikat në vijim janë paraqitur në lidhje me mosdeklaratat fizike ndërkufitare:

<b>Mosdeklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare</b>				
<b>Vitet</b>	<b>Numri i mosdeklarimeve</b>	<b>Vlera e mosdeklarimit të mjeteve</b>	<b>Valuta</b>	<b>Gjoba e shqiptuar (25%)</b>
<b>2019</b>	3	91,080.00	GBP	18,000.00 EURO
		33,200.00	EURO	91,080.00 GBP te konfiskuara ne total
		790	CHF	7.681.00 EURO
<b>2020</b>	1	65,450.00	EURO	16,362.50 EURO
<b>2021</b>	6	100,977.12	CHF	26,677.56 EURO
		70,509.82	EURO	17,627.46 EURO
		16,510.00	GBP	4,140 EURO
<b>Gjithsej</b>	10	<b>107,590.00</b>	<b>GBP</b>	<b>91,080.00 GBP te konfiskuara</b>
		<b>101,767.12</b>	<b>CHF</b>	
		<b>169,159.82</b>	<b>EURO</b>	<b>90,488.52 EURO</b>

Tabela 5: Mosdeklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2019-2021

## Analiza Operative dhe Strategjike

NjJIF-K ka mandat ligjor të kryejë:

(a) **analizë operative** që shfrytëzon informatat e disponueshme dhe të mundshme për t'u përfutur për të identifikuar subjektet specifike të synuara, për të ndjekur gjurmët e veprimtarive ose transaksioneve të caktuara dhe për të përcaktuar lidhjen midis këtyre subjekteve dhe të ardhurave të mundshme nga krimi, pastrimi i parave, veprat penale kryesore dhe financimi i terrorizmit; dhe

(b) **analizë strategjike**, që shfrytëzon informatat e disponueshme dhe të mundshme për t'u përfutur, përfshirë të dhënat që mund të sigurohen nga autoritetet e tjera kompetente, për të identifikuar prirjet dhe skemat që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Njësitë e Inteligjencës Financiare efektive duhet të jenë e pavarur dhe autonome në veprimtarinë e saj operative dhe duhet:

(a) të ketë autoritetin dhe aftësinë për kryerjen lirisht të funksioneve të saj, përfshirë vendimin autonom për të analizuar, kërkuar dhe/ose dërguar apo shpërndarë informacion të caktuar;

(b) lidhur me shkëmbimin e informacionit, të jetë në gjendje të lidhë marrëveshje apo të angazhohet në mënyrë të pavarur të bashkëpunojë me autoritete të tjera kompetente vendase ose me homologë të huaj;

(c) të ketë funksione të ndara themelore nga ato të autoritetit/ve tjera; dhe

(d) të jetë në gjendje të marrë dhe shfrytëzojë burimet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të saj, mbi baza individuale apo të zakonshme, e lirë nga çdo ndikim ose ndërhyrje e papërshtatshme nga politika, qeveria apo industria,

që do të komprometonte pavarësinë e saj funksionale.

Karakteristikat e një sistemi efektiv të inteligjencës financiare janë grumbullimi i një gamë të gjerë informacionit të fshehtë financiar dhe informata të tjera përkatëse dhe përdorimi i tyre për të hetuar pastrimin e parave, veprat penale kryesore të ndërlidhura me të dhe financimin e terrorizmit. Kjo ofron informacion të besueshëm, të saktë dhe të përditësuar dhe autoritetet kompetente kanë burimet dhe aftësitë që ta përdorin informacionin për të kryer analizën dhe hetimet e tyre financiare, për të identifikuar dhe gjurmuar pasuritë, si dhe për të hartuar analizën operative.

Gjatë gjithë procesit analitik grumbullohen, përpunohen dhe analizohen informacione shtesë, për t'u siguruar që inteligjencia e prodhuar të jetë një produkt "me vlerë të shtuar". Kjo vlen pa marrë parasysh se çfarë lloj analize po kryhet, qoftë strategjike apo operacionale (taktike).

Analiza e transaksioneve financiare në NJJIF-K zhvillohet mbi një qasje të bazuar në rrezik, ku funksioni analitik i NjJIF-K zhvillohet në bazë të një sërë procedurash të hollësishme dhe kryesisht të procedurave standarde të operimit gjithëpërfshirëse nga analistë me përvojë dhe të kualifikuar, duke përdorur mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit shumë të sofistikuar për futjen, ruajtjen, nxjerrjen e informacionit, përpunimin dhe shpërndarjen.

Autoritetet kompetente të Kosovës përdorin gjerësisht informacion financiar të shpërndarë nga NJJIF-K dhe të dhëna të tjera të disponueshme dhe të qasshme për të zhvilluar hetime paraprake për PP-në, veprat e ndërlidhura dhe FT-në.

Në vitin 2021, janë hapur gjithsej 1,014 raste për analizim:

Rastet e hapura për analizim 2017-2021					
Rastet e Hapura	2017	2018	2019	2020	2021
Rastet e hapura bazuar në RTD	147	68	64	261	195
Propozim rastet e hapura bazuar në RTD	0	505	474	868	582
Rastet e hapura nga NJIF-K (që i janë ofruar vullnetarisht NJIF-K-së)	6	4	6	8	8
Rastet e hapura nga Informatat Spontane nga FIU tjera	5	5	6	11	17
Kërkesat për shkëmbim të informacionit	140	159	167	173	200
Projektet e përbashkëta të analizave/hetimeve me Institucionet tjera të zbatimit të ligjit	12	6	5	3	12
<b>Gjithsej rastet e hapura për analizim</b>	<b>310</b>	<b>747</b>	<b>722</b>	<b>1324</b>	<b>1014</b>

Tabela 6: Rastet e hapura 2017-2021

Analiza strategjike është procesi i zhvillimit të njohurive (“inteligjencës strategjike”) që do të përdoret në formësimin e punës së NJIF në të ardhmen. Karakteristika kryesore e inteligjencës strategjike është se ajo nuk lidhet me raste individuale, por më tepër me çështje dhe trendet reja.

Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka hartuar “Udhëzuesit për Analizën Strategjike”. Me qëllim të përforcimit të këtyre analizave, dhe nën mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, stafi profesional i NJIF-K ka mbajtur trajnime të veçanta për analiza strategjike.

*Vlera e analizës përcaktohet nga dobia e saj për ‘përdoruesin përfundimtar’, kështu që prezantimi i suksesshëm i gjetjeve është thelbësor për të siguruar që puna analitike të ketë vlerën maksimale.*


Me 18.02.2021, NJIF-K ka miratuar dhe publikuar Udhëzues për subjektet raportuese për parandalimin e PP/FT si dhe rreziqet e PP/ FT që ndërlidhen me COVID-19 e cila përmban listën e indikatorëve/treguesve të cilët mund të ndihmojnë subjektet raportuese për të identifikuar, raportuar dhe parandaluar rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të shkaktuara gjatë periudhës COVID-19, si dhe tipologji të trendëve dhe rasteve të fundit që ndërlidhen me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

NJIF-K zhvillon analiza strategjike, kryesisht në formën e tipologjive, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e të kuptuarit të rreziqeve. Në vitin 2021, NJIF-K ka hapur për analizim 9 analiza strategjike me qëllim të prodhimit të tre produkteve kyçe të Analizës Strategjike;

- Produktet përshkruese
- Raportet e Tipologjive
- Raportet e trendëve

Analizat Strategjike të hapura për analizim 2018-2021				
Rastet e hapura për Analiza Strategjike	2018	2019	2020	2021
Produktet përshkruese	-	-	-	2
Raportet e Tipologjive	-	-	-	2
Raportet e trendëve	1	2	3	5
<b>Gjithsej</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>9</b>

Tabela 7: Analiza Strategjike të hapura 2018-2021



Grafiku 6: Analiza Strategjike të hapura 2018-2021

Ngjarjet më të rëndësishme në këtë fushë, të zhvilluara gjatë vitit 2021 kanë qenë:

- Miratimi i udhëzuesit për subjektet raportuese për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe rreziqet e PP/ FT që ndërlidhen me COVID-19. Ky dokument përshkruan rreziqet e reja gjatë periudhës COVID-19, faktorët kryesorë që janë duke nxitur këto rreziqe të reja gjatë periudhës COVID-19, si dhe tipologji të trendëve dhe rasteve të fundit që ndërlidhen me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.
- **Tipologjitë e përgjithshme të Pastrimit të Parave janë publikuar gjatë vitit 2021.** NJIF-K ka shqyrtuar rastet e pastrimit të parave që tregojnë trendët në sektorët e identifikuar përmes Vlerësimit të Riskut Kombëtar të Pastrimit të Parave.

Për më tepër, NJIF-K në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe nën mbështetjen e Projektit PECK III, kanë filluar me zhvillimin e Tipologjive të Financimit të Terrorizmit, produkt ky i iniciuar për herë të parë në vend.

Ndryshimet në trendët e rrezikut të PP/FT gjatë pandemisë COVID-19 janë shoqëruar me mënyra të ndryshme të reagimi nga qeveritë, të cilat përfshijnë ndihma sociale, nismat e lehtësimit të obligimeve tatimore, masat e kufizimit të lëvizjes dhe udhëtimeve. Ndërmarrja e këtyre masave mund të ofrojë mundësi të reja për kriminelët dhe terroristët, për të siguruar të ardhura të jashtëligjshme dhe mundësuar procesin e pastrimit të tyre.

## B. SHPALOSJA, SHPËRNDARJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

### Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet e zbatimit të ligjit

FIU shpërndan inteligjencën financiare tek organet përkatëse për të ndihmuar në zbulimin e dyshimit potencial të pastrimit të parave, veprave të tjera të ndërlidhura, financimit të terrorizmit dhe financimi i përhapjes.

Shpërndarja e inteligjencës financiare tek agjencitë e zbatimit të ligjit është një nga funksionet thelbësore të NjIF-K. Inteligjenca financiare u mundëson partnerëve tanë të zbatimit të ligjit të hetojnë krimet bazë, pastrimin e parave dhe aktivitetet e financimit të terrorizmit. Për më tepër, ato sigurojnë një bazë për ndjekjen penale të personave kur është e nevojshme.

Raportet e inteligjencës së NJIF gjithashtu ofrojnë profilizimin e të ardhurave të dyshuara të krimit dhe të ardhurave të rrjedhura nga aktivitetet tjera.

Për zhvillimin e inteligjencës, NjIF analizon transaksione të dyshimta dhe informacione të tjera të transaksioneve financiare. Rezultatet e analizave të RTD-ve u shpërndahen agjencive përkatëse të zbatimit të ligjit përmes një raporti të veçantë të shpërndarjes.


Në vitin 2021, 203 raporte të inteligjencës janë shpërndarë për hetime të mëtutjeshme tek agjencionet e zbatimit të ligjit apo 28% më tepër krahasuar me vitin paraprak 2020 (158 raporte të shpërndara në vitin 2020).

Raportet e shpërndara gjatë vitit 2021 janë mbështetur kryesisht në flukset e raportimit të RTD-ve të dërguara nga subjektet raportuese gjatë vitit në fjalë, por edhe RTD-të e viteve paraprake. Këto raporte i nënshtrohen procesit të analizimit



nga NJIF-K dhe kur evidentohen element të dyshimtë për pastrim të parave, financim të terrorizmit, apo vepra të ndërlidhura, ato shpërndahen për agjencitë e zbatimit të ligjit për veprime të mëtejshme hetimore.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat e raporteve të shpërndara nga NJIF-K në pesë vitet e fundit (periudha 2017-2021):



Grafiku 7: Raportet e shpërndara të inteligjencës 2015-2021

Raportet e shpërndara të inteligjencës 2017-2021					
Referuar në institucione përkatëse	2017	2018	2019	2020	2021
Policia e Kosovës	60	57	74	71	84
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	4	8	4	18	12
Administrata Tatimore e Kosovës	40	33	52	46	76
Dogana e Kosovës	2	2	0	1	4
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	1	3	3	7	8
Agjencia Kundër Korrupsionit	3	2	1	0	0
EULEX	2	1	0	0	0
FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan	5	13	15	12	16
Tjera	2	2	2	3	3
<b>Gjithsej</b>	<b>119</b>	<b>121</b>	<b>151</b>	<b>158</b>	<b>203</b>

Tabela 8: Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2017-2021

## Ndihma hetimore e ofruar për agjencitë e zbatimit të ligjit

NjIF-K gjithashtu ofron ndihmë për agjencitë e zbatimit të ligjit sipas kërkesës. Kërkesa për ndihmë nga institucionet kompetente të ndjekjes penale dhe hetimit pranohen në formë të shkruar dhe kanë të bëjnë kryesisht me hetimet e aktiviteteve të dyshimta të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura penale të tilla si Evazioni fiskal, Korrupsioni dhe ryshfeti, Trafiku i drogës, Kontrabanda, Falsifikimi dhe pirateria e mallrave, Trafikimi i qenieve njerëzore,


Prostitucioni, Mashtrimi, Grabitja dhe vjedhja, Zhvatja dhe fajtjet, Krimet Kibernetike etj.

Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka pranuar 200 kërkesa për shkëmbim të informacionit, 8% më tepër se vitin paraprak (185 kërkesa në vitin 2020). Si gjithëherë, numri më i lartë i kërkesave edhe gjatë vitit 2021 ka rrjedhur nga Policia e Kosovës (41% e gjithsej kërkesave të pranuar), kurse pjesa tjetër pasohet nga AKI, Dogana, Prokuroria e Shtetit:

Institucionet parashtruese të kërkesës	Numri i kërkesave
Policia e Kosovës	82
AKI	38
Prokuroria e Shtetit & PSRK	19
ATK	1
Dogana e Kosovës	33
ILECU	12
BQK	10
Tjera	5
<b>Gjithsej</b>	<b>200</b>

Tabela 9: Shkëmbimi i informacionit - vendor 2021

Në të shumtën e rasteve, kërkesat për shkëmbim të informacionit (IRD) ndërlidhen me një hetim të filluar nga një shpërndarje e inteligjencës së NJIF-K të rrjedhur nga RTD-të që u shpërnda për hetime të metutjeshme në një agjenci të zbatimit të ligjit.



Grafiku 8: Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF 2016-2021


Numri gjithnjë në ngritje i informacionit të shkëmbyer mes institucioneve tregon për një ngritje të vazhdueshme të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe rritje të rrjedhës së informacionit midis sektorit privat dhe NJIF-së për t'i siguruar pastaj zbatuesit e ligjit me inteligjencën e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e

pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura përfshirë edhe korrupsionin, evazionin fiskal etj.

### Shkëmbimi i informacionit dhe mbështetja për mbikëqyrësit e pajtueshmërisë

Me qëllim të mbikëqyrjes, monitorimit, trajtimit dhe zbutjes së rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në sektorët financiarë, NJIF-K dhe BQK kanë shkëmbyer informacione duke bërë edhe identifikimin dhe verifikimin e pronarëve përfitues me pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo që mbajnë funksione drejtuese në institucionet financiare, e gjithë kjo në funksion të parandalimit që kriminelët dhe bashkëpunëtorët e tyre të zotërojnë apo të jenë pronarë përfitues me pjesëmarrje të konsiderueshme ose kontrolluese apo në funksione drejtuese në institucionet financiare.


Gjatë vitit 2021, BQK ka parashtruar 10 kërkesa për shkëmbim të informacionit me NJIF-K:



Grafiku 9: Shkëmbimi i informacionit me mbikëqyrësit e pajtueshmërisë 2016-2021

## C. NGRIRJA E TRANSAKSIONEVE BANKARE DHE SANKSIONET

Numri i udhëzimeve të lëshuara nga NJIF-K në vitin 2021 për pezullim të transaksioneve ose ngrirjen e përkohshme e transaksioneve, ka qenë gjithsej 46 urdhra ngrirje, në vlerë totale të transaksioneve të pezulluara/ngrira prej **8,975,202 Euro**, që tregon për performancën më të mirë të treguar ndonjëherë që nga themelimi i NJIF-K.



Grafiku 10: Vlera e transaksioneve/fondeve të ngrira nga NJIF-K 2015-2021

Qëllimi i ngrirjes së transaksioneve është që të parandaloj pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si dhe rikthimin e të ardhurave nga krimi.

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare ndaj individëve dhe subjekteve të përcaktuar, dhe për të parandaluar financimin e akteve terroriste dhe për të ngrirë pasuritë financiare të subjekteve të listuar ose mbështetësve të tyre në Republikën e Kosovës, ka marrë vendim për zbatimin e sanksioneve të cilat konsistojnë në:

- Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët dhe entitetin e sanksionuar;
- Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar; dhe
- Ndalim për persona dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.

NJIF-K është e autorizuar të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet si dhe të lëshojë urdhër për moskryerjen e transaksionit apo të kërkojë nga subjektet raportuese të monitorojë llogaritë apo marrëdhënien e biznesit për një periudhë kohore deri në tre (3) muaj; apo për një periudhë shtesë siç përcaktohet nga NJIF-K (paragrafi 1.12 i nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit).

Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka lëshuar 9 urdhra të monitorimit të llogarive apo marrëdhënies së biznesit, të cilat konsistojnë në:

Viti 2021	
Urdhrat e monitorimit të lëshuar nga NJIF-K	Nr. i urdhrave të lëshuar
Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare (Zbatimi i Vendimeve të Qeverisë)	3
Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare (OFAC lista, etj)	1
Parandalimi dhe luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	5
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>

Tabela 10: Urdhrat e monitorimit të lëshuar nga NJIF-K 2021

Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2015-2021							
Urdhrat për ngrirje	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit	6	85	3	4	3	31	46
Shuma (EUR)	29,740	1,036,146	1,007,933	250,852	151,060	1,093,643	8,975,202

Tabela 11: Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2015-2021

## KAPITULLI III - MBIKËQYRJA E PAJTUESHMËRISË

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me kërkesat e ligjore për parandalimin e PP/FT, përbën një nga prioritetet kryesore strategjike të NJIF-K.

Mbikëqyrja efektive e bazuar në rrezik është element thelbësor i një sistemi të fuqishëm të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave.

Mbikëqyrësit e pajtueshmërisë luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e sistemit financiar dhe sektorëve të tjerë nga keqpërdorimi nga kriminelët dhe terroristët duke:

- rritur ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese dhe të kuptuarit e rreziqeve të PP / FT, rekomandimin për masat përmirësuese dhe inkurajojnë të obliguarit ligjorë në përdorimin e praktikave të mira,
- zbatuar dhe monitoruar pajtueshmërinë me detyrimet e PPP / LFT, dhe
- marrë masa të duhura kur identifikohen mangësitë.
- Për të kryer këtë funksion në mënyrë efektive dhe efikase, mbikëqyrësit duhet të zbatojnë një qasje të bazuar në rrezik.

Për këtë qëllim, NJIF-K nën mbështetjen e projekteve ndërkombëtare kanë hartuar Manualin për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik për sektorin e BPCJF-ve dhe Udhëzuesin dhe mjetin për zbatimin e mbikëqyrjes së PPP/LFT-së bazuar në rrezik për sektorin financiar dhe gjithë sektorët tjerë.

## MBIKËQYRJA E BAZUAR NË RREZIK

Strukturat efektive të mbikëqyrjes luajnë rol kryesor për efektivitetin e regjimit PPP/LFT në vend. Qasja e ndjekur nga autoritetet e vendit është duke u përmirësuar gjithnjë në vazhdimësi dhe bazohet në praktikën më të mira të njohura në nivelin ndërkombëtar për krijimin e funksioneve mbikëqyrëse mbi PPP/LFT-në.

Qasja mbikëqyrëse e bazuar në rrezik njihet si praktikë shumë e mirë në nivelin ndërkombëtar dhe është një kërkesë e standardeve të FATF-së. Duke ditur që shumica e agjencive mbikëqyrëse, përfshirë edhe Kosovën kanë burime të kufizuara, qasja mbikëqyrëse e bazuar në rrezik i lejon autoritetet të përcaktojnë se cilat aktivitete mbikëqyrëse janë më të përshtatshme bazuar në rrezikun e mospërbushjes lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të pranishme brenda një sektori të veçantë dhe njësive përkatëse të raportimit.

Qasje mbikëqyrëse e bazuar në rrezik paraqet disa përparësi strategjike. Kjo synon të përqendrojë burimet e kufizuara mbikëqyrëse tek sektorët dhe subjektet me rrezik më të lartë. Kjo qasje e synuar synon të arrijë nivelin më të lartë të përmbushjes me shpërndarjen minimale të burimeve. Zakonisht, subjektet me rrezik të ulët pajisen me material edukativ, trajnime dhe aktivitete të vetëdijesimit duke përfshirë edhe rekomandimet për masat përmirësuese, ndërsa burimet e inspektimit në NJIF-K kryesisht përqendrohen tek subjektet me rrezik më të lartë. Zbatimi i një qasje të tillë gjithëpërfshirëse e bazuar në rreziqe, do të çojë në një situatë ku pjesa dërrmuese e subjekteve raportuese të jenë në përputhje me obligimet ligjore ndërsa subjektet që nuk janë në pajtueshmëri do t'i nënshtrohen inspektimeve dhe veprimeve korrigjuese.

NJIF-K është duke bërë përpjekje maksimale që qasja e bazuar në rrezik të integrohet në të gjitha aspektet e hartimit të programit mbikëqyrës. Kjo


pastaj do të shërbejë për zhvillimin e të gjitha funksioneve mbikëqyrëse.

Qasja progresive ndaj mbikëqyrjes së sektorit financiar dhe BPCJF-ve përmban aktivitete që shkojnë nga vetëdijesimi, te inspektimi dhe veprimet korrigjuese.

## Inspektimi i pajtueshmërisë në vend dhe mbikëqyrja nga distanca

Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka ndërmarrë 31 inspektime të pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca.

Duke ju përshtatur edhe masave të përcaktuara për parandalimin e pandemisë COVID-19, inspektimet janë fokusuar kryesisht në ato me fushëveprim të kufizuar, tematik dhe nga distanca (77% kanë qenë inspektime në distancë) të cilat kanë përbërë pjesën më të madhe të inspektimeve të kryera në vitin 2021.




Grafiku 11: Inspektimi i Pajtueshmërisë sipas llojit 2021

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik është e ndërtuar në analizim të përgjithshëm të rrezikut, duke i renditur subjektet e mbikëqyrura në bazë të rrezikut dhe është bërë një përzgjedhje të bazuar në rrezik përmes analizimit të rrezikut të identifikuar nga subjektet raportuese dhe renditjes në bazë të rezultateve të vlerësimit të rreziqeve për PP/FT.

Fokus i inspektimeve në vitin 2021 ka qenë i përqendruar në veprimet dhe masat që duhet të

ndërmerren nga subjektet raportuese, duke u përqendruar kryesisht në nxjerrjen e rregulloreve dhe procedurave të brendshme të shkruara, vendosjen e kontrolleve për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe zbatimin e tyre, procedurën për kujdesin e duhur ndaj klientit, përfshirë procedurën për identifikimin dhe verifikimin e klientit, procedurën e raportimit sipas nenit 26 të ligjit për PPP/LFT dhe dërgimit të informacionit, në NjIF-K, emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë, përfshirjen e listës së indikatorëve të hartuar nga NjIF, për identifikimin e personave dhe transaksioneve në lidhje me të cilat ka arsye për të dyshuar për pastrim të parave ose financim të terrorizmit etj.



Grafiku 12: Inspektimi i Pajtueshmërisë ne vend dhe nga distanca 2014 - 2021

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë në vitet 2016-2020.

Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2017-2021										
Subjektet raportuese të inspektuara	2017		2018		2019		2020		2021	
	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
Banka	1	10	-	-	1	2	1	-	2	-
Institucione Mikrofinanciare	-	15	3	-	1	-	-	-	1	-
Kompani të Sigurimit dhe Sigurimit të Jetës	-	-	-	1	2	1	-	-	-	-
Zyrat e Këmbimit Valutor	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-
Agjensione për transferime të parave	1	5	-	-	1	-	1	-	-	-
Kazino dhe Lojra te Fatit	-	-	4	-	-	-	-	-	-	-
OJQ	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Auditor & Kontabilistë	-	-	-	-	-	-	-	19	2	-
Noterët	12	-	6	-	-	17	-	-	-	24
Agjensione për patundshmëri	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Auto Sallone	-	-	-	-	-	-	10	-	-	-
<b>Inspektimet në vend dhe distancë</b>	<b>14</b>	<b>30</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>20</b>	<b>12</b>	<b>19</b>	<b>7</b>	<b>24</b>
<b>Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë</b>	<b>44</b>		<b>14</b>		<b>25</b>		<b>31</b>		<b>31</b>	

Tabela 12: Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca 2017-2021

## Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim

Pas çdo mbikëqyrje të pajtueshmërisë, NjIF-K dhe mbikëqyrësit tjerë të përcaktuar në Ligjin për PPP/LFT, ashtu siç përcaktohet në ligj mund të:

- rekomandojnë masat përmirësuese;
- shqiptojnë ndëshkim administrativ; apo
- procedojnë çështjen në procedurë penale

Dështimi nga subjektet raportuese të definuar në nenin 16 të Ligji Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore

të parashikuara në këtë ligj, që nuk janë vepra penale, përbëjnë shkelje administrative të cilat klasifikohen si shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.

Gjatë vitit 2021, NjIF-K me qëllim të zbutjes së rrezikut dhe ndërmarrjes së masave përmirësuese ka lëshuar një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për masat përmirësuese që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese, si dhe janë vendosur masa administrative.

Gjithsej 130 rekomandime për masat përmirësuese janë dhënë për subjektet e inspektuara, përderisa është shqiptuar 1 ndëshkim administrativ në vlerë monetare prej gjithsej 10,000 Euro.

Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2021			
Subjektet raportuese	Rekomandimet për masat përmirësuese	Numri i Ndëshkimeve administrative	Vlera monetare e gjobave të shqiptuara (Euro)
Banka		1	10,000
Institucione Mikrofinanciare	2		
Zyrat e Këmbimit Valutor	4		
Auditor & Kontabilistë	12		
Noterët	112		
Gjithsej	130	1	10,000

Tabela 13: Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2021

Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ merren në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë,

fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.

## Aprovimi i zyrtarit të pajtueshmërisë për PPP/LFT


Rregullorja për funksionin e pajtueshmërisë dhe kriteret për i përshtatshëm dhe i duhur për zyrtarin e pajtueshmërisë përcakton:

- funksionin e pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,
- Rolin e Bordit Drejtues/ Përgjegjësit ekuivalent,
- Rolin e menaxhmentit të lartë në subjektet raportuese,

- Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarit për Pajtueshmëri për PPP/LFT,
- Kriteret për i përshtatshëm dhe i duhur për Zyrtarin e pajtueshmërisë për Bankat dhe Institucionet Financiare,
- Listën e indikatorëve kyç të rreziqeve dhe indikatorëve kyç të performancës sa i përket pajtueshmërisë së PP/FT,

Gjatë vitit 2021 jam pranuar gjithsej 23 aplikacione për aprovimin e zyrtarit të pajtueshmërisë, ku të gjitha janë aprovuar.

Procesi i Përbushjes së kriterëve për i përshtatshëm dhe i duhur nga zyrtari i emëruar për PPP/LFT është si në vijim:





## Vetëdijesimi, trajnimi dhe komunikimi për PPP/LFT dhe përforsimi i partneritetit publiko-privat dhe publiko-publik

Ngritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bëhet nga NjIF-K duke përforsuar Partneritetin Publiko Privat, zhvilluar komunikimin dhe duke siguruar për shoqërinë, e sidomos për subjektet raportuese, informata gjithëpërfshirëse dhe korrekte rreth natyrës, shkallës dhe ndikimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, masat preventive të disponueshme dhe përgjegjësitë ligjore të subjekteve raportuese. NjIF-K promovon pjesëmarrjen aktive të shoqërisë.

Vetëdijesimi dhe sensibilizimi në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit përbën njërin nga objektivat specifik të prioriteteve strategjike të NjIF-K.

Me 28.01.2021, NjIF-K në mbështetje nga UNDP kanë organizuar një seminar me titull "Trajtimi i Personave të Ekspozuar Politikisht si klientë, identifikimi i klientëve dhe aktiviteteve të dyshimta, dhe Tipologjitë e Pastrimit të Parave - Praktikat më të mira nga sektorët privat dhe publik". Pjesëmarrës mbi 150+ të gjithë përfaqësuesit e bankave private të Kosovës, subjekteve të tjera raportuese të sektorit privat dhe institucionet publike.

Njësia për Inteligjencë Financiare (NjIF-K) në bashkëpunim me Asociacionin e Mikrofinancave të Kosovës (AMIK) me datë 05/03/2021 në kuadër të trajnimeve dhe vetëdijesimit të rregullt në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese sa i përket obligimeve ligjore, ka mbajtur punëtorin me temë "Vlerësimi i rrezikut Kombëtar për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të

Terrorizmit, Tipologji dhe Rreziqet për PP/FT që ndërlidhen me Covid - 19". Në këtë punëtori ishin prezent (12) dymbëdhjetë pjesëmarrës nga IMF, në mesin e tyre përveç zyrtarëve të pajtueshmërisë për PPP/LFT kishte edhe zyrtar si menaxherë të degëve, si dhe nga sektori i IT.



Me 07.06.2021 NjIF-K në mbështetje të UNDP kanë organizuar uebinarin "Skemat e Pastrimit të Parave me Monedha Virtuale". Uebinari ka eksploruar trendët e reja të skemave për pastrim të parave që përfshijnë monedhat virtuale dhe kriptomonedhat, dhe si të identifikohet sa më mirë veprimtaria e dyshimtë kriminale si nga zbatuesit e ligjit/rregullatorët financiarë dhe pajtueshmëria e sektorit privat dhe profesionistët kundër pastrimit të parave. Pjesëmarrës të gjithë përfaqësuesit e bankave private të Kosovës dhe subjekteve të tjera raportuese të sektorit privat, të agjencive të zbatimit të ligjit që merren me hetimet e krimit financiar, të Njesisë për Inteligjencë Financiare, të Administratave Tatimore dhe Doganore, dhe të Bankës Qendrore.

Më 10 Qershor 2021 është organizuar një konference online në të cilën është bërë lansimi i Vlerësimit të Riskut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Kosovës. Ngjarja kishte për qëllim të paraqiste gjetjet për herë të parë të Vlerësimit Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, miratuar nga Qeveria, për agjencitë e zbatimit të ligjit nga prokuroria, policia, administratat e

taksave dhe doganave, pastaj BQK dhe sektorin privat. Përfaqësues nga Njësitë e Inteligjencës Financiare në Shqipëri, Bullgari, Maqedoninë e Veriut, Turqi dhe Slloveninë ndanë komentet e tyre mbi Vlerësimin e Kosovës dhe eksperiencën e tyre gjate vlerësimeve ne secilin nga këto vende te regjionit.

Dt.16.09.2021, NJIF-K në mbështetje te Projektit kundër Krimin Ekonomik (PECK III) kane mbajtur një webinar "prezantimi i Tipologjive të Financimit te Terrorizmit". Rreth 90 pjesëmarrës nga institucione të ndryshme publike duke përfshirë organet e zbatimit të ligjit, Shoqërinë Civile dhe subjektet raportuese nga sektori bankar/jobankar përfituan nga udhëzimet për masat parandaluese të financimit të terrorizmit dhe prezantimin e rasteve dhe tipologjive praktike. Tipologjitë u zhvilluan përmes bashkëpunimit të ngushtë dhe kontributit të madh nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) dhe Policia. Autoritetet janë të përkushtuara që të marrin parasysh rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar dhe të ndër marrin veprimet e nevojshme për t'u përafuar më tej me standardet ndërkombëtare.

Me datë 15 Dhjetor 2021 në Odën Amerikane u realizua forumi me temë 'Parandalimi i Pastrimit të Parave në Ekonomi' dhe ndikimin e tyre, forum ky i cili zgjoi interes të madh nga ana e bizneseve. Forumi është bashkëorganizuar me Oden Ekonomike Amerikane ne Kosove.

Me datë 25 - 26 Nëntor dhe 9 - 10 Dhjetor 2021, NJIF-K nën mbështetjen e PECK III kane organizuar dy aktivitete trajnimi/punëtorie me sektorin bankar dhe agjencionet e zbatimit te ligjit. Këshilli i Evropës ofron udhëzime për identifikimin e pronarëve përfitues përfundimtarë për autoritetet e Kosovës.

Me datë 08/02/2021, NJIF-K ka mbajtur një takim me përfaqësues nga Oda e Notereve me qëllim te diskutimit lidhur me organizimin e disa trajnimeve për noteret ne regjione te ndryshme.

Me datë 25.02.2021, NJIF-K ka mbajtur një takim me Shoqatën e Bankave (SHBK) ku agjenda e takimit ka qenë:

- Trajtimi i OJQ-ve nga sektori bankar;
- Mundësia e raportimit në bazë të kryerësit të transaksionit (conductor base) e jo bazuar në llogari (account base);
- Institucionet e parave elektronike;

Me qëllim të avancimit të bashkëpunimit mes institucioneve publike të interesit në fushën e shkëmbimit të informacioneve kadastrale dhe pronësore, me datën 11 mars 2021 në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur një takim pune mes delegacioneve gjithëpërfshirëse nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, nga Administrata Tatimore e Kosovës nga Njësia për Inteligjencë Financiare, Ministria e Financave UNDP. Temë kryesore e takimit ishte trajtimi i mundësive për plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike si rrugë për lirim nga pagesa për produktet dhe shërbimet kadastrale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës për institucionet publike, respektivisht për Administratën Tatimore të Kosovës, Policinë e Kosovës, EULEX-in, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Gjykatat Themelore, Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Njësinë për Inteligjencë Financiare. Në takim palët u pajtuan që këto çështje të adresohen në instanca edhe më të larta, ndërsa për këtë qëllim u propozua që të zgjerohet rrjeti i bashkëpunitorëve nga institucionet publike.

Për më tepër, NJIF-K ka mbajtur takime tjera vetëdijësuese me Zyrën Kadastrale Komunale Prishtine; me ZKK Lipjan dhe ZKK Ferizaj.

Me 20 Tetor 2021 Shoqata e Bankave te Kosovës ka mbajtur takim konsultues për te diskutuar çështjen e Projektligjit për Identifikim Elektronik si dhe ndërlidhjen e këtij ligji qe mund ta këtë me fushën e AML-se. Përveç NJIF-K ne takim te ftuar kanë qenë

edhe përfaqësues nga Banka Qendrore e Kosovës,  
Ministria për Zhvillim Ekonomik (si sponsorizuese  
e këtij projektligji) si dhe përfaqësues nga Këshilli  
Gjyqësorë i Kosovës.

## KAPITULLI IV - VLERËSIMI I RREZIKUT KOMBËTAR (VRK)

Rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kuptohen dhe, kur është nevoja, veprimet bashkërendohen brenda vendit për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit e përhapjes.

Karakteristikat e një sistemi efektiv të vlerësimit të rrezikut përfshijnë identifikimin, vlerësimin dhe të kuptuarit si duhet rreziqet e tij të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe bashkërendon brenda vendit veprimet që do të zbatohen për të zbutur këto rreziqe. Këtu përfshihet angazhimi i autoriteteve kompetente dhe autoriteteve të tjera përkatëse; përdorimi i një game të gjerë burimesh të besuara të informacionit; përdorimi i vlerësimit/vlerësimeve të rreziqeve si bazë për hartimin dhe caktimin e përparësive të politikave dhe aktiviteteve të PPP/LFT-së; dhe komunikimi e zbatimi i këtyre politikave dhe aktiviteteve në mënyrë të bashkërenditur përmes kanaleve të duhura. Po ashtu, autoritetet kompetente përkatëse bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë politikat dhe aktivitetet për të luftuar financimin e përhapjes. Me kalimin e kohës, këto sjellin si rezultat zbutjen e konsiderueshme të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

## VLERËSIMI I RREZIKUT KOMBËTAR (VRrK) DHE PLANI I VEPRIMIT

Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka zhvilluar Planin e Veprimit për adresimin e të gjeturave të raportit të Vlerësimit Kombëtar.

Ky Plan Veprimi është integruar në Planin e rishikuar të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës në Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.

Për më tepër me qëllim të zbutjes dhe menaxhimit të rrezikut të PP/FT, NJIF-K gjatë vitit 2021 ka ndarë raportin e vlerësimit kombëtar me subjektet raportuese dhe institucionet e zbatimit të ligjit dhe ato rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Më 10 qershor 2021, Njësia për Inteligjencë Financiare, në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë përmes projektit të tij për Mbështetjen e Përpjekjeve Kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK III), ka organizuar një konferencë për lancimin e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.






Aktiviteti kishte për qëllim prezantimin e gjetjeve për herë të parë të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të miratuar nga Qeveria, para agjencioneve të zbatimit të ligjit si dhe sektorit privat. Përfaqësues nga Njësitë e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, Turqisë dhe Slloveni ndanë komentet e tyre për Vlerësimin e Kosovës.

Prezantimi i vendeve të rajonit mbi procesin e VRrK dhe hapat që kanë bërë për zbatimin e masave ishin me vlerë të madhe për autoritetet e vendit.

Një element thelbësor i regjimit të LPP/LFT është një vlerësim adekuat dhe efektiv i rrezikut.

Vlerësimi i rrezikut është themeli i një kuadri proporcional të bazuar në rrezik për LPP/LFT. Subjektet raportuese duhet të kenë një kuptim të qartë të rreziqeve dhe dobësive të PP/FT me të cilat përballen gjatë rrjedhës së biznesit. Vlerësimi i rrezikut është dokumenti thelbësor për të gjithë regjimin e LPP/LFT.

Niveli i kërcënimit të pastrimit të parave nga veprat penale të përshkruara:

Veprat penale të përshkruara	Niveli i kërcënimit
Evazioni fiskal Korrupsioni dhe rryshfeti	 Jashtëzakonisht i lartë
Trafiku i drogës Kontrabanda Falsifikimi dhe pirateria e mallrave Trafikimi i qenieve njerëzore Prostitucioni	 I lartë
Mashtrimi Grabitja dhe vjedhja Zhvatja dhe fajdet Krimet Kibernetike	 Mesatar
Trafikimi i paligjshëm i armëve Krimet mjedisore	 I ulët
Falsifikimi i monedhës Trafikimi i paligjshëm me mallra të vjedhura Falsifikimi	 Jashtëzakonisht i ulët

Grafiku 14: Niveli i kërcënimit të pastrimit të parave nga veprat penale të përshkruara

## KAPITULLI V - TIPOLOGJITË SEKTORIALE

Tipologjitë e pastrimit të parave janë pjesë e përpjekjeve të Njësisë për Inteligjencë Financiare për uljen e nivelit të korrupsionit, ekonomisë informale dhe veprave tjera të ndërlidhura të PP/FT dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve subjekteve raportuese në mënyrë efikase, transparente, llogaridhënëse.

**Tipologjitë e përgjithshme të Pastrimit të Parave janë publikuar gjatë vitit 2021.** NJIF-K ka shqyrtuar rastet e pastrimit të parave që tregojnë trendët në sektorët e identifikuar përmes Vlerësimit të Riskut Kombëtar të Pastrimit të Parave. Rastet e ilustruara në tipologji përshkruajnë elementet që duhet të identifikohen gjatë trajtimit të klientëve të dyshimtë dhe aktiviteteve financiare. Publikimi do të shërbejë si një referencë e vlefshme për sektorin privat dhe publik në zhvillimin e kontrolleve të brendshme dhe vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave

Seksioni vijues ilustron rreziqet e pastrimit të parave në kuadër të sektorëve të ndryshëm ekonomikë të Kosovës. Për këtë qëllim jepen raste ilustrime, së bashku me një analizë të rreziqeve që ato përfaqësojnë, si dhe trendët në zhvillim.

## Bizneset dhe profesionet e përcaktuara jo-financiare (BPCJF)

Nën-seksioni i mëposhtëm shqyrton risqet specifike për pastrim të parave të profesionistëve të lira në kuadër të kategorisë së BPCJF-ve. Këto subjekte klasifikohen si të tilla nga FATF-i pasi ato posedojnë risqe të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe nuk klasifikohen si institucione financiare.

Bizneset dhe profesionet e caktuara jofinanciare janë:

- a) agentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme;
- b) avokatët dhe noterët;
- c) kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimor;
- d) trusti dhe ofruesit e shërbimeve
- e) shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar;
- f) personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë.



## Avokatët

Natyrë dhe rang i shërbimeve që ofrojnë avokatët janë të gjera. Këta profesionistë janë të kualifikuar t'i këshillojnë qytetarët në lidhje me ligjin dhe t'i përfaqësojnë ata në gjykatë.

Avokatëve mund t'u kërkohet të ndihmojnë në strukturimin dhe dizajnin e transaksioneve që synojnë të fshehin natyrën dhe origjinën e fondeve. Organizatat kriminale mund të veprojnë në shkallë të ndryshme. Më të mëdhatë kanë shumë asete për t'u pastruar dhe kjo detyrë mund të jetë e vështirë të realizohet pa ndihmën e avokatëve dhe kontabilistëve. Për rrjedhojë, shumica e tipologjive të paraqitura në këtë dokument mund të supozojnë në një moment këshillimin/ndërmjetësimin me vetëdije të këtyre profesionistëve.

## Sinjale alarmi për PPP

Avokatët mund të përfshihen në aktivitete kriminale përmes një larmie veprimtarish, pasi shërbimet që ata ofrojnë shkojnë nga hartimi i kontratave të punës, tek themelimi i kompanive dhe përfaqësimi i klientëve.

Kriminelët mund të përpiqen t'i ngatërrojnë ose maskojnë lidhjet ndërmjet fitimeve të një krimi dhe autorit të krimit përmes krijimit të instrumenteve të korporatave ose aranzhimeve të tjera juridike (d.m.th. fonde të mirëbesimit). Kriminelët mund t'i përdorin transferet e pronave për të shërbyer si mbulesë për transfere të fondeve të paligjshme (shtresim) ose si investim përfundimtar të këtyre fitimeve pasi të pastrohen fitime nga krimi (integrimi).

Kriminelët mund t'i përdorin këta profesionistë për të kryer operacione të ndryshme financiare në emër të tyre (p.sh. depozitat në para të gatshme, operacione të këmbimit të monedhës, blerje dhe shitje të aksioneve).

Vështirësia në marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për ta identifikuar një klient është një nga sinjalet kryesorë të alarmit për PPP.

Kriminelët janë të interesuar ta maskojnë identitetin e tyre dhe/ose t'i pozicionojnë fitimet e paligjshme sa më larg që të jetë e mundur nga vetja. Avokatët bëhen të dobishëm në këtë detyrë pasi ata shpesh bëhen ndërmjetës. Në këtë mënyrë, njohja e klientit tuaj nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm në identifikimin e duhur të palëve, por edhe në të kuptuarit e burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve. Dokumentacionet fiktive që shërbejnë për këto besohet se janë një nga sinjalet më të shpeshtë të alarmit. Kriminelët mund të tregojnë interes edhe për krijimin e subjekteve juridikë tepër komplekse në vende me mbikëqyrje të dobët qeveritare.

Avokatët duhet t'i interpretojnë këto interesa si sinjale alarmi për aq kohë sa nuk ka asnjë arsye për konfigurimin juridik të këtyre subjekteve përveç fshehjes së pronësisë përfituese të aseteve.

## Kontabilistët dhe auditorët

Kontabilistët profesionistë në praktikën publike mund të ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh, të cilat përfshijnë shërbime të auditimit dhe sigurimit; mbajtjen e regjistrave dhe përgatitjen e llogarive vjetore dhe periodike, si dhe punën për pajtueshmërinë tatimore; shërbime mirëbesimi dhe të kompanisë.

Firmat më të mëdha ndërkombëtare të kontabilitetit që veprojnë në Kosovë, në përgjithësi zbatojnë politikat e tyre të PPP/KFT-së në nivel global, ndërkohë që kompanitë më të vogla shfaqin më shumë hendekë në njohuritë e tyre për riskun nga PP/FT të paraqitur nga klientët, dhe për detyrimet e tyre në sistemin e PPP/KFT-së.

Mungesa e raportimit të RTD-ve mund të jetë një shenjë se ka pak PP të lidhur me sektorin por ka më



shumë gjasa të jetë një shenjë mungese e kontrollit dhe të kuptuarit të PPP/KFT-së në këtë sektor.

#### Sinjale alarmi për PPP

Disa nga shërbimet e ofruara nga këta profesionistë janë më të ndjeshme ndaj risqeve të pastrimit të parave.

Kur bëhet fjalë për kontabilistët dhe auditorët, kriminelët mund të jenë të interesuar të marrin këshilla se si t'i minimizojnë detyrimet tatimore ose t'i vendosin asetet aty ku nuk kontrollohen, për të shmangur detyrimet e ardhshme fiskale.

Kriminelët mund të jenë edhe të interesuar të marrin konfirmime për pasqyra financiare mashtruese, duke maskuar kështu performancën aktuale financiare të subjekteve të biznesit.

#### Noterët

Noterët janë me risk të konsiderueshëm marrë parasysh përmasat dhe rëndësinë e sektorit të pasurive të patundshme dhe të ndërtimtarisë në Kosovë.

Noterët mund të përfshihen në të gjitha transaksionet që lidhen me shitjen e pronave të luajtshme dhe të patundshme, duke përfshirë pasurinë e patundshme, dhe si të tillë kanë një rol shtesë në regjimin parandalues për transaksionet e patundshmërive.


Këta profesionistë kanë tendencë të kenë një rol të rëndësishëm në kuadër të sektorit të BPPJF-ve, pasi ata janë të përfshirë në shumicën e transaksioneve që lidhen me formimin e kompanive dhe transferimin e pasurive të patundshme.

#### Sinjale alarmi për PPP

Noterët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në pastrimin e të ardhurave, por veprojnë si mundësues për shpëlarësit. Rasti i përgjithshëm është blerja e një prone me çmim të nënvlerësuar, me çmimin që pranohet nëpërmjet noterit. Fitimet e paligjshme më pas do të përdoren për të paguar "nën tryezë" për pjesën e mbetur. Më vonë prona mund të shitet me çmim të plotë. Noterët janë gjithnjë të përfshirë në këto transaksione, por jo gjithmonë janë të vetëdijshëm për implikimet penale.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave të Kosovës në sektorin e BPCJF-ve:

## Tipologjia I




Subjekti A, i interesuar për të shitur një subjekt biznesi në Kosovë, dhe subjekti B, i interesuar për ta blerë, e kryejnë transaksionin përmes një firme juridike.

Sipas burimit të fondeve të subjektit B, të ardhurat vjetore nga aktiviteti i vet i biznesit nuk kanë asnjë lidhje logjike me shumën që posedon për blerjen e subjektit të biznesit. Fondet për blerjen janë me origjinë të dyshimtë.

### TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- ✓ Burimi i paqartë i fondeve - subjektet raportuese duhet të bëjnë çmos për njohjen e klientit dhe që ta kuptojnë burimin e tij të fondeve.

## Tipologjia II




Detyrimet fiktive u krijuan me mbikëqyrjen e një kontabilisti. Subjekti i biznesit angazhoi një furnizues të rremë dhe një të punësuar të rremë që ra dakord të bëhej palë në një skemë me të cilën subjekti i biznesit do t'i llogariste shpenzimet e rreme në pasqyrën e të hyrave (d.m.th. shpenzimet për pagimin e pagës/kostos së mallrave të shitura).

Kjo rritje e rreme e shpenzimeve uli të hyrat e tatueshme dhe në këtë mënyrë shërbeu si një instrument për të shmangur pagesën e tatimeve..

### TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- ✓ Mospërputhja ndërmjet asetëve dhe detyrimeve - janë krijuar detyrime të rreme për të ulur të hyrat e tatueshme. Rënia në të hyrat e tatueshme ul detyrimet tatimore të subjektit të biznesit. Qeveria merr më pak të hyra ndërsa subjekti i biznesit nuk sheh një rritje të detyrimeve dhe shpenzimeve të veta.



Noteri ndërmjetësoi në shitjen e një pasurie të patundshme në Kosovë. Sipas kontratës çmimi i pronës ka një vlerë dukshëm nën çmimin e tregut. Tatimi u paguar në këtë çmim (70% e çmimit të pasurive të patundshme).

Subjektet A dhe B, me ndihmën e noterit, dakordohen për një pagesë shtesë të paregjistruar dhe në para të gatshme për 30 përqindëshin e mbetur të çmimit sipas vlerës së tregut të pronës. Nuk paguhet asnjë tatim për këtë transaksion në para të gatshme.

### TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- ✓ Çmimi i pronës së patundshme është i gabuar - çmimi zyrtar i transaksionit të pasurive të patundshme është dukshëm më i ulët/më i lartë se çmimi i tregut. Nëse është dukshëm më i ulët, palët në transaksion mund të jenë të interesuara për uljen e pagesave tatimore; nëse është dukshëm më i lartë, palët mund të jenë të interesuara të simulojnë shpenzime më të larta për të kërkuar lehtësime tatimore..

## KAPITULLI VI - BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Rezultatet konkrete në luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit arrihen vetëm nëpërmjet ngritjes së platformave të forta multidisiplinare të bashkëpunimit. Mekanizmat vendas të bashkëpunimit ndërmjet shumë agjencive funksionojnë nëse bazohen në një njohje të plotë të vlerës së shtuar që sjell shkëmbimi i informacionit dhe praktikave më të mira, të cilat rrjedhin nga aktivitetet/përpjekjet e përbashkëta. Autoritetet e Kosovës kanë zhvilluar një sërë mekanizmash për të vlerësuar rreziqet nga pikëpamja si gjithëpërfshirëse, ashtu edhe sektoriale; janë krijuar mekanizma në baza periodike dhe në vazhdimësi.

Përveç bashkëpunimit kombëtar, NJIF-K gjithashtu bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë. Ky bashkëpunim është një nga kushtet kryesore për aftësinë për të siguruar informacionin financiar që gjeneron inteligjencë të dobishme financiare.

## BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI VENDOR

Përforcimi i partneritetit Publiko-Publik mbetet ndër prioritetet strategjike të NJIF-K. Bashkëpunimi i NJIF-K me autoritetet tjera kompetente, shtrihet përveç tjerash në tri lloje kryesore të bashkëpunimit:

- Bashkëpunimi me autoritetet kompetente që kanë funksione dhe kompetenca të hetimit dhe/ose ndjekjes penale të pastrimit të parave, veprave të lidhura me të, financimit të terrorizmit dhe sekuestrimit/ngriritjes dhe konfiskimit të aseteve kriminale;
- Bashkëpunimi me autoritetet kompetente që kanë përgjegjësi mbikëqyrëse të LPP/LFT dhe autoritetet kompetente që pranojnë raporte për transportin ndërkufitar të parave të gatshme dhe instrumentet e negociueshme;
- Bashkëpunimi me autoritetet e tjera publike kompetente me përgjegjësi të caktuara për luftimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit.

Autoritet e Kosovës kanë zhvilluar një sërë mekanizmash për bashkëpunim dhe bashkërendim shtetëror duke përfshirë mekanizmat për të vlerësuar rreziqet nga pikëpamja si gjithëpërfshirëse, ashtu edhe sektoriale, si dhe janë krijuar mekanizma në baza periodike dhe në vazhdimësi. Po ashtu mekanizmat për të bashkërenduar politikat vendore të PPP/LFT-së.


Në përgjigje të gjetjeve të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar dhe Raportit të Vlerësimit të ndërsjellë (MER), Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar Grupin Punues për të bashkërenduar aktivitetet në

fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e politikave afatgjata dhe afatshkurtra, i kryesuar nga NJIF-K për të bërë monitorimin e duhur të zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit për të mundësuar që të rishikoj efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me neni 14 të Ligjit Nr. 05/L - 096 për PPP/LFT.

Gjatë vitit 2021, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstucional dhe koordinimit bazuar në rreziqet e identifikuar, janë zhvilluar shtatë takime për koordinim bazuar në rreziqet e identifikuar.

**Policia e Kosovës (PK)** është përgjegjëse, ndër të tjera, për sigurimin e rendit dhe sigurisë publike, luftimin e krimit të organizuar dhe garantimin e integritetit të kufijve. Bashkëpunimi i NJIF-K me PK shtrihet kryesisht me Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), që përfshin Sektorin për Hetime Financiare dhe Njësinë e PP-së, që merret posaçërisht me krimin financiar dhe pastrimin e parave si dhe Sektorin e

Hetimeve të Integruara Financiare që është përgjegjës për të zhvilluar hetime mbi veprat penale që ndërlidhen me krimin e organizuar. NJIF-K dhe Policia e Kosovës kanë zhvilluar bashkëpunimin edhe përmes zyrtarëve ndërlidhës. Rreth 41% e raporteve të gjithëmbarshme të inteligjencës shpërndahen për hetime të mëtutjeshme nga NJIF-K tek PK.



**Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)** është organi qendror përgjegjës për mbledhjen e të

ardhurave tatimore në Kosovë dhe hetimin e shmangies nga tatimi. NJIF-K dhe ATK kanë rickaktuar zyrtarët ndërlidhës. Rreth 37% e raporteve të inteligjencës financiare që ndërlidhen me dyshimet e shmangies tatimore shpërndahen për hetime të mëtutjeshme në ATK.

**Dogana e Kosovës (DK)** përveç tjerash mbikëqyr dhe siguron zbatimin e deklarimit të detyruar të qarkullimit të instrumenteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës. NJIF-K dhe DK kanë të shkëmbyer zyrtarët ndërlidhës. Rreth 17% e informacionit të inteligjencës financiare shpërndahet nga NJIF-K në Doganën e Kosovës.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) promovon dhe mban stabilitetin e sistemit financiar, sistemit të pagesave, si dhe stabilitetin e çmimeve. Banka Qendrore është gjithashtu autoriteti mbikëqyrës për të gjitha institucionet financiare në Kosovë, duke përfshirë institucionet e kreditit bankare dhe jobankare, dërguesit e parave, shkëmbimet e valutave dhe shoqëritë e sigurimeve.

**Zyra e Prokurorit të Shtetit (PSH)** është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale ose akteve të tjera të përcaktuara me ligj. **Prokuroria Speciale (PSRK)** ka kompetencë ekskluzive të hetojë dhe të ndjekë penalisht, ndër të tjera, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Bashkëpunimi i NJIF-K me Prokuroritë Themelore është ngritur në veçanti në gjurmimin dhe identifikimin e pasurisë së fshehur që rrjedh nga aktivitetet e paligjshme dhe që mund të shërbej për ngrirje dhe sekuestrim.


**Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI)** është themeluar si shërbim i sigurisë dhe i inteligjencës në Kosovë. AKI-ja ka status juridik dhe kompetencë për të vepruar në të gjithë territorin e Kosovës. AKI-ja mbledh informacion për kërcënimet ndaj sigurisë në Kosovë: terrorizmin, krimin e organizuar, trafikimin, etj. NJIF-K dhe AKI kanë të shkëmbyer zyrtarët ndërlidhës. Për më tepër me

qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe përforcimit të masave të sigurisë shtetërore, NJIF-K dhe AKI më 14.10.2021 kanë lidhur marrëveshje për zyrtarin ndërlidhës. Tanimë dy zyrtarë ndërlidhës të AKI-së operojnë në NJIF-K.

**Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimin Ekonomik (KKLKE)** promovon, bashkërendon, monitoron, vlerëson dhe raporton për aktivitetet e institucioneve të zbatimit të ligjit që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimin që gjeneron përfitime materiale. NJIF-K raporton në baza të rregullta periodike dhe shkëmben informatat kthyes me KKLKE.

Për shkak të natyrës unike të rolit të NJIF-K dhe të dhënave të tij, ajo pranon në mënyrë rutinore kërkesa për shkëmbim të informatave (IRD) nga agjencitë partnere vendase për të mbështetur operacionet e tyre. Numri i kërkesave të bëra në NJIF-K në 2021 është ngritur për 8% krahasuar me vitin paraprak, me 200 kërkesa këtë vit krahasuar me 185 të pranuar vitin e kaluar.

Numri më i lartë i kërkesave përgjatë vitit 2021 ka rrjedhur nga Policia e Kosovës (82 kërkesa), i përcjellë nga AKI (38 kërkesë), Prokuroria e Shtetit & PSRK (19 kërkesa). Për llogari të autoriteteve të tjera (ATK, Doganë, ILECU, AKK, BQK) janë trajtuar 61 kërkesa për shkëmbim të informacionit.



Grafiku 15: Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF-K

Në pajtim me nenin 14 të Ligji Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, NJIF-K është e autorizuar të përpilojë informata, statistika, raporte dhe, duke u bazuar në ato, t'u bëjë rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës dhe personave apo organeve të tjera relevante, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlydhura penale dhe financimin e terrorizmit. Nisur nga kjo, gjatë vitit 2021 NJIF-K ka përcjell tek autoritetet tjera katër (4) rekomandime si në vijim:

- ◇ Ministrinë e Drejtësisë - Projekt Strategjia për Sundimin e Ligjit - Rekomandim në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlydhura penale dhe financimin e terrorizmit
- ◇ Me qëllim të zvogëlimit dhe menaxhimit të rrezikut të identifikuar nga Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, NJIF-K ka lëshuar Rekomandim për Sekretariatën e Strategjisë Kombëtare 2019-2023, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Rishikimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2019-2023<sup>4</sup>;
- ◇ Policinë e Kosovës - Raporti i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë/Rekomandim;
- ◇ Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës - Raporti i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë/Rekomandim

---

<sup>4</sup> Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

NJIF-K dhe AZL janë pjesë e grupit për zbulimin dhe shënjestrimin e krimit të rëndë që udhëhiqet nga PSRK dhe që vepron në pajtim me Procedurat Standarde të Operimit për Përzgjedhjen dhe Shënjestrimin e rasteve të Krimeve të Rënda dhe Ekipeve Hetimore Ndër-Agjenci. Si rezultat, përfaqësuesi i NJIF-K gjatë vitit 2021 ka marrë pjesë në katër takime të Ekipit të Përbashkët për Përzgjedhjen dhe Shenjëstrimin e Krimeve të Rënda.

### **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

Ndërsa teknologjitë e reja dhe në zhvillim janë duke pasur impakt në lëvizjen më të shpejtë të parave në nivel global, krimi i organizuar, lehtësuesit profesionist të pastrimit të parave dhe akterët e tjerë të përfshirë në aktivitete që gjenerojnë të ardhura nga krimi apo për qëllime të financimit të terrorizmit, janë të shpejtë në shfrytëzimin e këtyre mundësive. NJIF-K zhvillon dhe aplikon një qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar duke udhëhequr përpjekjet e Qeverisë për përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel ndërkombëtar, ku përfshijnë:

- forcimin e bashkëpunimit me NJIF homologe të huaj, me Egmont, dhe ngritja e bashkëpunimit me vendet e rajonit duke luajtur një rol aktiv në organizatat ndërkombëtare të LPP/LTF;
- ngritjen dhe zhvillimin e inteligjencës financiare ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi;
- shkëmbimi i informacionit operacional dhe inteligjencës me NJIF të tjera, agjencitë e zbatimit të ligjit në mbarë botën;
- ofrimin e praktikave më të mira dhe pjesëmarrja aktive në hartimin e

udhëzuesve dhe dokumenteve tjera të fushës së LPP/LFT-së;

- mbështetjen e projekteve dhe partnerëve ndërkombëtarë nëpërmjet asistencës teknike dhe trajnimit.

## Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

NJIF-K lehtëson shkëmbimin e inteligjencës financiare midis autoriteteve të Kosovës dhe homologëve të tjerë ndërkombëtar. Si në rrafshin operacional, ashtu edhe në atë strategjik, NJIF-K është partnere e rëndësishme ndërkombëtare si në rajon, vendeve të BE-së dhe përtej oqeanit.

Zhvillimi i përpjekjeve për pjesëmarrje në takimet plenare dhe takimet e ndërmjetme të Grupit Egmont, si dhe grupit punues rajonal të NJIF-eve, për të përmirësuar shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2021.

Është kënaqësi e veçantë për NJIF-K të përfaqësohet në strukturën më të lartë organizative të Egmont Group, pas një periudhe shumë të shkurtër anëtarësimi në këtë mekanizëm të fuqishëm ndërkombëtar. Një nga zyrtarët e NJIF-K është përzgjedhur në pozitën e Zëvendës Kryetarit tek Grupi i Punës për Asistencë Teknike dhe Trajnim (TATWG). TATWG është përgjegjëse për identifikimin, zhvillimin dhe ofrimin e asistencës teknike dhe trajnimit për anëtarët e Grupit Egmont dhe FIU-të kandidatë, në bashkëpunim me organizatat Observer dhe partnerët ndërkombëtarë. Kjo tregon edhe një herë për profesionalizmin e lartë të stafit profesional të NJIF-K. Kjo përveç se do të kontribuoj në promovimin e institucionit dhe vendit në rrafshin ndërkombëtar, do të ketë impakt pozitiv edhe në zhvillimin rajonal të FIU-ve.

Nga data 1 deri më 10 shkurt 2021, NJIF-K ka marrë pjesë në katër takime të grupeve punuese të Egmont:

- ⇒ Egmont Group meetings - IEWG Virtual meetings (1-4.02.2021)
- ⇒ Egmont Group meetings -TATWG Virtual meetings (8-9.02.2021),
- ⇒ Egmont Group meetings - PPWG Virtual meetings (10.02.2021)
- ⇒ Best Egmont Case Award (BECA) Book II

Nga data 28 Qershor deri më 9 Korrik, NJIF-K ka marrë pjesë në takimin Plenar të 27 të Egmont Group (Virtual). Katër zyrtarë të NJIF-K kanë marrë pjesë në takimet e grupeve punuese përfshirë edhe takimet e udhëheqësve të NJIF-ve (HoFIU Meetings):

Takimet e grupeve punuese:

- Meeting of the Egmont IT Professionals (June 28th, 2021 )
- Information Exchange Working Group – project teams’ meetings (June 28th, 2021 )
- Technical Assistance and Training Working Group meeting (June 28th, 2021)
- Information Exchange Working Group meeting (June 29th, 2021)
- Membership, Support and Compliance Working Group meeting (June 30th, 2021)
- Policy and Procedures Working Group meeting (July 2nd, 2021);

Takimet e Drejtorëve të NJIF-ve:


- o HoFIU and Egmont Committee sesioni i mbyllur- 6 Korrik, 2021:
- o HoFIU Webinar 1 - FIUs and the Risk-Based Approach: An Environmental Scan and Implementation - July 6th, 2021
- o HoFIU Webinar 2 - FIU Processes and Data Protection in the Application of the Risk-based Approach - July 8th, 2021:
- o HoFIU Webinar 3 - Making a Difference: Enhancing Capacity and Capability of FIUs in Producing High-quality Financial Intelligence through the Risk-based Approach - July 8th, 2021.

Gjatë vitit 2021, zyrtarët e NJIF-K kanë qenë pjesë aktive e trajnimeve dhe kurseve të mbajtura në



kuadër të platformës ECOFEL<sup>5</sup> duke zgjeruar njohuritë dhe përforcuar kapacitetet në fushat me interes si: Analiza Strategjike, Analiza Operacionale, Lehtësuesit Profesionist të Pastrimit të Parave, Roli i NjIF-ve në vlerësimet kombëtare të rrezikut të PP / FT: mësimet e marra, COVID-19 - Praktikant më të mira për NjIF-ët, Mjetet e Korporatës, Pavarësia dhe autonomia operationale e NjIF-ëve etj.

## BEST EGMONT CASES – Financial Analysis Cases 2014–2020



Egmont Group ka publikuar botimin e rasteve më të mira “BEST EGMONT CASES – Financial Analysis Cases 2014–2020”<sup>6</sup>. Ky libër shënon publikimin e dytë të përpilimit të rasteve studimore nga konkursi

BECA, pas publikimit të parë të botuar në 2015.

Është kënaqësi për NjIF-K që ka kontribuar në përpilimin e këtij libri dhe është përzgjedhur në mesin e rasteve më të mira të publikuara në këtë botim të Tipologjive më të mira të Egmont (BECA). NjIF-K bën përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e bashkëpunimit të suksesshëm ndërkombëtar me NjIF-ët homologe të Grupit Egmont, goditjen e pastruesve të parave dhe kthimin e pasurive të përfituara nga aktiviteti kriminal tek viktimat e mashtrimit dhe krimeve të tjera financiare.

<sup>5</sup> Egmont Centre of FIU Excellence and Leadership (ECOFEL)

<sup>6</sup> [https://egmontgroup.org/wp-content/uploads/2022/01/2021-Financial.Analysis.Cases\\_.2014-2020-3.pdf](https://egmontgroup.org/wp-content/uploads/2022/01/2021-Financial.Analysis.Cases_.2014-2020-3.pdf)

Volumi i dytë i këtij libri “BEST EGMONT CASES”, përmban 26 raste studimore, të cilat nxjerrin në pah një sërë tipologjish të PP/FT, duke përfshirë:

- Ryshfetin dhe Korrupsionin
- Krimet kibernetike dhe kriptovalutat
- Trafikimin e narkotikëve
- Mashtrimin dhe përvetësimin
- Kontrabandën dhe bixhozin
- Pastrimin e parave të bazuar në tregti dhe pastrimin e parave nga palët e treta
- Terrorizmin, Krimin e Organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore

Pritshmëria e këtij botimi do të jenë me vlerë të shtuar për profesionistët e NjIF-it, zbatuesit e ligjit, agjencive të tjera qeveritare dhe subjektet raportuese nga sektori privat. Lexuesit gjithashtu do të kuptojnë se si hetimet më të mira, të suksesshme dhe bashkëpunimi i ngushtë midis akterëve kryesorë brenda dhe jashtë vendit luan rol të rëndësishëm në suksesin e tyre.

5

### Unprecedented Global Multibillion Cryptocurrency Euro Fraud (Kosovo, FIU-Kosovo)

**Introduction**

The CUMA case is the first successful stand-alone money laundering indictment and prosecution in Kosovo involving a global multibillion-dollar cryptocurrency fraud, OneCoin. It resulted in the largest single confiscation of assets ever, totalling nearly EUR 1 million, which was upheld by the appellate court. It was initiated only two months after Kosovo was admitted to Egmont and succeeded due to cooperation with 17 Egmont Group members. The entire case from filing of the suspicious transaction report (STR) to the court verdict was completed in a record time of 18 months.

**The Investigation**

The case was initiated on the basis of an STR submitted by a bank. The Financial Intelligence Unit (FIU) in Kosovo followed up with qualitative analysis of the individuals and companies listed. After this, tactical cooperation with the reporting entity led to further intelligence that was used to build a case against the company and the owners.

<b>Keywords</b>	money laundering, cryptocurrency, fraud, tax evasion
<b>Countries involved</b>	Kosovo, Denmark, Germany and Poland
<b>Sectors involved</b>	banking, precious metals and precious stones trade

Through the STR, FIU-Kosovo determined that there were three entities: two international websites and one local entity, CUMA, which had four shareholders: two Kosovo nationals and two Danish citizens who opened CUMA, the Kosovo-registered company, offering online tutorial packages for investing in the cryptocurrency OneCoin.

Date from police, taxation and Business Registration Agency databases did not provide information that tied the involved persons to money laundering or other related offences. Through searching open sources, FIU-Kosovo found that the Danish citizen owed debts to the Danish tax and other authorities, as well as a criminal record. FIU-Denmark confirmed this.

Preliminary analysis of financial activity revealed that OneCoin at the time was not considered a pyramid scheme, although there were warnings for customers issued by some authorities (BaFin in Germany and from Bulgaria, Italy and the United Kingdom). Nonetheless, FIU-Kosovo opened a case and scored it with a prioritized high risk.

FIU-Kosovo continued to use open sources to find more information on the websites that CUMA's owner provided to the bank: onlife.eu and nbi.za. This information and the STR led FIU-Kosovo to uncover the connection between OneLifeNetwork Ltd. and OneCoin.

FIU-Kosovo then discovered the Facebook profile for one of the local owners and analyzed his fingerprints in photos, which indicated that he was a manual labourer and likely a house painter or construction worker. FIU-Kosovo in collaboration with the bank decided to check if this person has any knowledge related

## Bashkëpunimi Regional

Nga data 3 deri më 5 Nëntor 2021, NjIF-K është ftuar për herë të parë në takimin e forumit të vendeve të frankonisë "Francophone's FIUs

Financial Cooperation Forum". Takimi është mbajtur në Monaco.



Me 1 Tetor 2021 është mbajtur Konferenca Rajonale me Njësitë e Inteligjencës Financiare të shteteve të Ballkanit Perëndimor " Regional Conference with Financial Intelligence Offices from Western Balkan" me temë "Krimi i organizuar, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit: Trendët , sfidat dhe praktikat më të mira", me folës kryesorë dhe përfaqësues përkatës nga Njësitë për Inteligjencë Financiare të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Takimi kishte për fokus tri sesione:

- Session 1 - National trends and regional cooperation;
- Session 2 - Country perspective on regulation of Crypto;
- Session 3 - Risk Assessment of money laundering and financing of terrorism



Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka dhënë kontributin e saj në disa projekte të rëndësishme ndërkombëtare të zhvilluara nga Egmont Group dhe nën grupi i përfaqësimit regional Europa II.

**Grupi Drejtues i Zotimeve të Sigurisë të Procesit të Berlinit (SCSG) - NJIF-K** si pjesë e Grupit Drejtues të Zotimeve të Sigurisë të Procesit të Berlinit ka marrë pjesë në dy takimet e Grupit Drejtues. Në takimin e mbajtur në formatin virtual më 19 Maj 2021, SCSG ka nxjerrë disa nga konkluzionet që ndërlidhen me PP/FT dhe luftimin e korrupsionit.

Anëtarët e SCSG që përfaqësojnë gjashtë juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, vendet anëtare pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian dhe institucionet e Bashkimit Evropian, rrjetet e bashkëpunimit rajonal dhe agjencitë e tjera partnere morën pjesë dhe kontribuan në këtë takim. Gjatë këtij takimi anëtarët e SCSG-në diskutuan për progresin e arritur lidhur me Udhërrëfyesin Rajonal Antikorrupsion dhe Financat e Paligjshme, Vlerësimin e Kërcënimeve për Rreziqet e Pastrimit të Parave dhe ushtrimin e hartës së mekanizmave rajonale të shkëmbimit të informacionit.


### [Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve](#)

NJIF-K ka autoritetin për të shkëmbyer drejtpërdrejt inteligjencën me homologët e huaj sipas nenit 15 (4) të ligjit Nr. 05/L -096. Rrjeti i sigurt i Egmont (ESW) është kanali kryesorë për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit përderisa të gjithë NJIF-ët anëtare të Egmont mund të kenë qasje përmes tij, përderisa ekzistojnë edhe disa mënyra tjera të shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit me ato vende që nuk janë anëtare të Egmont ose për kohësisht nuk kanë qasje në ESW.

Aktualisht, Njësitë e Inteligjencës Financiare të 167 vendeve janë anëtarë të Grupit Egmont. NJIF-K është anëtare e Grupit Egmont që nga 1 Shkurt 2017.

Natyra dhe shtrirja e bashkëpunimit ndërkombëtar është definuar në rekomandimet e FATF-së dhe aktin themelues (kartën) të Grupit Egmont, Parimet dhe Udhëzimet Operacionale të saj.

Gjatë vitit 2021 janë shkëmbyer gjithsej 137 informata me homologët e huaj.




Grafiku 16: Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit 2015-2021

Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2017-2021					
Bashkëpunimi ndërkombëtar	2017	2018	2019	2020	2021
<b>KËRKESAT E PRANUARA</b>					
Kërkesat e huaja të pranuar nga NjIF-K	33	32	26	32	43
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NjIF-K	0	0	0	0	0
Ndarja spontane e informacionit të marrë nga NjIF-K	7	12	19	28	21
<b>GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i pranuar)</b>	<b>40</b>	<b>44</b>	<b>45</b>	<b>60</b>	<b>64</b>
<b>KËRKESAT E DËRGUARA</b>					
Kërkesat e dërguara nga NjIF-K	37	62	74	42	55
Ndarja spontane e informacionit të dërguar nga NjIF-ët	5	13	15	13	18
<b>GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i dërguar)</b>	<b>42</b>	<b>75</b>	<b>89</b>	<b>55</b>	<b>73</b>

Tabela 14: Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2017-2021

Gjatë vitit 2021, NJIF-K ka dërguar 55 kërkesa në 36 NjIF të huaja dhe pranoi 43 kërkesa nga 17 NjIF të huaja.



Grafiku 17: Kërkesat e huaja të pranuar dhe dërguara nga NJIF-K 2017-2021

## Memorandumi i Mirëkuptimit

Neni 15.4 i jep po ashtu NjIF-K kompetencën që të nënshkruaj me homologët e huaj marrëveshje ose memorandum mirëkuptimi (MM) për shkëmbimin e informacionit. Megjithatë, memorandum i mirëkuptimit nuk është parakusht për shkëmbim të informacionit ndërmjet NjIF-K dhe një NjIF-i të huaj, aktualisht NJIF-K ka nënshkruar 19 MM, përfshirë rishikimet dhe ripërtëritjet e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me disa vende.

MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj		
Juridiksioni		Viti
	Shqipëria (DPPPP)	2009
	“Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë” (MLPD)	2009
	Mali i Zi (APML)	2009
	San Marino (FIA)	2009
	Slovenia (OMLP)	2009
	Kroacia (AMLO)	2010
	Turqia (MASAK)	2012
	Republika Çeke (FAU-CR)	2012
	Finlanda (FIU)	2013
	Polonia (GIIF)	2014
	Shqipëria (DPPPP) – ripërtëritje	2014
	Hungaria (HFIU)	2015
	Maqedonia (FIO) – ripërtëritje	2015
	Ghana (FIC)	2015
	Lituania (FNTT)	2016
	Jordania (AMLU)	2018
	Senegal (CENTIF)	2018
	Mali i Zi (FIU)	2019
	Taiwan (AMLD)	2020

Tabela 15: MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj

## Ngrirja e përkohshme e transaksionit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar

Kur të jetë e nevojshme, NjIF-K do t'i kërkojë një NjIF-i të huaj që të ngrijë një transaksion për llogari të NjIF-K me të njëjtat parakushte sikurse kjo të bëhet në nivel vendor. Koha maksimale për ngrirje është e përcaktuar nga baza ligjore e shtetit të NjIF-it që e pranon kërkesën.

Kur kërkohet nga një NjIF i huaj, NjIF-K do të ngrijë përkohësisht një transaksion në Kosovë në të njëjtën mënyrë sikurse iniciativa për ngrirje të kishte ardhur nga vet NjIF-K.

## Informatat kthyesë

NjIF-K mund të jap ose kërkojë informata kthyesë tek apo nga NjIF-et e huaja në lidhje me kualitetin, afatin dhe dobishmërinë e informacionit të marrë/dërguar.

Informatat kthyesë për të maksimizuar reagimin tonë ndaj partnerëve tanë të Egmont, ka qenë një nga prioritetet e vendosura të NJIF-K për vitin 2021. Gjatë këtij viti, NJIF-K ka njoftuar thujtë në çdo rast homologët e huaj në lidhje me pranimin e kërkesës/informacionit spontan dhe regjistrimin e tyre në sistem. Po ashtu në raste të caktuara, varësisht nga kërkesa janë kthyer edhe informata kthyesë për homologët e huaj, qoftë për rezultatin e analizave ose për kualitetin e shkëmbimit të informacionit.

## MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

### Projekti i financuar nga BE-ja&KiE PECK III

Më 30 Qershor 2020, ka filluar Projekti i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës (PECK III)<sup>7</sup> me një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe një buxhet prej 2,225,000 Euro (financuar nga fondet e BE: 89,89% dhe fondet e CoE: 10,11%).


PECK III bazohet në rezultatet e dy fazave të mëhershme të projektit të përbashkët të BE/Këshilli i Evropës kundër Krimin Ekonomik në Kosovë dhe mbështet autoritetet në adresimin e gjetjeve të vlerësimeve të Këshillit të Evropës rreth “Pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare në Fushën e luftimit të korrupsionit” (Vlerësim anti-korrupsion) dhe “Pajtueshmëria e Kosovës me standardet ndërkombëtare në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit” (Vlerësimi PPP/LFT). Në këtë mënyrë, Projekti ka për qëllim të ndikojë në zbatimin e praktikave të zhvilluara të luftimit të korrupsionit dhe PPP/LFT në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane dhe praktikave të mira krahasuese. Kjo do të bëhet përmes zhvillimit të kapaciteteve efektive dhe të qëndrueshme për parandalimin dhe eliminimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe kthimin e pasurisë.

Përfituesit kryesorë të Projektit PECK III janë: Njësia për Inteligjencë Financiare, Agjencia Kundër Korrupsionit, Prokuroria e Shtetit, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Policia e Kosovës, BQK.

Në mbështetje të një sistemi më efektiv të PPP / LFT në Kosovë, në vitin 2021, Projekti PECK III ka

mbështet disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë këtij viti të cilat ishin përqendruar kryesisht në:

- ⇒ zhvillimin e tipologjive të financimit të terrorizmit në Kosovë;
- ⇒ forcimi i analizës strategjike të NjIF në Kosovë;
- ⇒ Prezantimi i analizës për kompetencën për ndjekjen penale të shpëlarjes së parave në Kosovë;
- ⇒ Rregullorja e pronësisë përfituese dhe përfrimi i saj me standardet ndërkombëtare;
- ⇒ Subjektet raportuese pajisen me udhëzime për tipologjitë e financimit të terrorizmit;
- ⇒ Trajnim për trajnerë të Akademisë së Drejtësisë dhe Akademisë për Siguri Publike për financimin e terrorizmit;
- ⇒ ofrimi i udhëzimeve për identifikimin e pronarëve përfitues përfundimtarë për autoritetet e Kosovës.



<sup>7</sup> Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK III)

## Mbështetja e UNDP ndaj përpjekjeve antikorrupsion në Kosovë (SAEK) - Mbështetja për NJIF-K

**UNDP SAEK ka mbështetur NJIF-K dhe autoritetet hetimore në ngritjen e kapaciteteve dhe çështjeve që lidhen me pastrimin e parave dhe rastet e korrupsionit.**

**Përforcimi i analizave strategjike në NJIF-K përmes** ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit të udhëzuesit për analiza strategjike. Trajnime të Analizës Strategjike - katër webinar trajnimi u zhvilluan më 15, 17, 23 dhe 25 mars 2021, në të cilat stafi i NjIF u trajnuar mbi aspektet praktike të kryerjes së analizave strategjike

**UNDP SAEK më tej ka mbështetur NJIF-K në zhvillimin e tipologjisë për botimin e rasteve më të mira "BEST EGMONT CASES - Financial Analysis Cases 2014-2020".** NJIF-K ka kontribuar në përpilimin e këtij libri dhe është përzgjedhur në mesin e rasteve më të mira të publikuara në këtë botim të Tipologjive më të mira të Egmont (BECA).

**Plani i Veprimit për Vlerësimin e rrezikut kombëtar të pastrimit të parave (NRA).** NRA është miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Dhjetor 2020. Një përmbledhje e NRA do të botohet dhe do të prezantohet publikisht në 2021, dhe një Plan Veprimi për zbatimin e masave që burojnë nga NRA do të zhvillohet në 2021.

**Konferenca online në të cilën është bërë lansimi i Vlerësimit të Riskut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Kosovës.** Ngjarja kishte për qëllim të paraqiste gjetjet për herë të parë të Vlerësimit Kombëtar të Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, miratuar nga Qeveria në Dhjetor 2020, për agjencitë e zbatimit të ligjit nga prokuroria, policia, administratat e taksave dhe doganave, pastaj BQK

dhe sektorin privat. Përfaqësues nga Njësitë e Inteligjencës Financiare në Shqipëri, Bullgari, Maqedoninë e Veriut, Turqi dhe Slloveninë ndanë komentet e tyre mbi Vlerësimin e Kosovës dhe eksperiencën e tyre gjatë vlerësimeve në secilin nga këto vende të regjionit.

**Përforcimi i partneritetit publiko-privat:** Trajnim për sektorin publik dhe privat në trajtimin e Personave të Ekspozuar Politikisht si klientë, identifikimin e klientëve dhe aktiviteteve të dyshimta, dhe Tipologjitë e Pastrimit të Parave. Seminari online ka eksploruar praktikën më të mirë në trajtimin e PEP-ve si klientë, identifikimin e klientëve dhe veprimtarive të dyshimta dhe tipologjitë e pastrimit të parave të identifikuara si nga subjektet raportuese të sektorit privat ashtu edhe nga Njësitë e Inteligjencës Financiare.

**Trajnim për skemat e Pastrimit të Parave me Monedha Virtuale.** Uebinari ka eksploruar trendet e reja të skemave për pastrim të parave që përfshijnë monedhat virtuale dhe kriptomonedhat, dhe si të identifikohet sa më mirë veprimtaria e dyshimtë kriminale si nga zbatuesit e ligjit/rregullatorët financiarë dhe pajtueshmëria e sektorit privat dhe profesionistët kundër pastrimit të parave.

## Programi Global i Luftimit të Flukseve Financiare të Paligjshme (FPF) - Projekti i GIZ<sup>8</sup>

Programi Global i GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) "Lufta kundër qarkullimit të paligjshëm të fondeve" (IFF) është duke zbatuar një sërë aktiviteteve në vendet e Ballkanit

---

<sup>8</sup> Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) - German-Norwegian Cooperation in Combating Illicit Financial Flows in the Western Balkans

Perëndimor, me qëllim forcimin e kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese.

Qëllimi i programit është të përmirësojë kushtet për luftën kundër FPF. Programi implementon një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë tri fusha kryesore:

- **Parandalimin;**
- **Hetimin financiar dhe**
- **Rikthimin e Pasurive**

Gjatë vitit 2021, GIZ ka mbështet NJIF-K dhe autoritetet tjera në Kosovë, në disa fusha kryesore që përfshijnë:

- **Forcimin e mbikëqyrjes së bazuar në risk për BPCJF** duke përfshirë
  - Udhërrëfyesin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT) - Kosovë;
  - Udhërrëfyesi i mbikëqyrjes i bazuar në rrezik për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT) - Ballkani Perëndimor;
  - Modeli i manuali të mbikëqyrjes së parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/FT) bazuar në rrezik - Ballkani Perëndimor.
- **Zhvillimin e legjislacionit dhe ndërtimin e regjistrit nacional të pronësisë përfituese.** Kjo përfshinë përveç tjerash hartimin e koncept dokumentit, draftimin e ligjit, punëtorit për grupin punues dhe palët e interesit dhe asistencën teknike në ndërtimin e regjistrit nacional të pronësisë përfituese;
- Një nga aktivitetet e parashikuara në projekt ka të bëjë me **zhvillimin e një programi trajnimi për hetimet financiare**, ku përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në hetimin dhe

ndjekjen penale të fondeve të paligjshme dhe rikuperimin e të ardhurave, të pajisen me teknikat proaktive të hetimeve financiare. Gjithashtu, synon krijimin dhe forcimin e grupeve hetimore të përbashkëta me përfaqësues të institucioneve të ndryshme. Duke qenë se ky aktivitet i fokusuar vetëm në institucionet e Kosovës është zhvilluar në tre faza, ku përveç fazave I dhe II (analiza e nevojave për trajnim dhe zhvillimi i programit), në fazën e tretë është parashikuar që ekspertët ndërkombëtar të zhvillojnë aktivitetet e mëposhtme:

- a) Trajnimi fillestar mbi hetimet financiare paralele, grupet e përbashkëta të hetimit (joint investigative teams) dhe punën ndër-institucionale (17 - 21 maj 2021)
  - b) Trajnimi i avancuar mbi hetimet financiare (24 - 28 maj 2021)
  - c) Mentorim (21 - 25 qershor 2021)
- Projekti ka mbështet autoritetet në takimin e "Kick-off meeting on Beneficial Ownership Transparency in Kosovo Tax Justice Network" (TJN) & (GIZ);
  - **Hartimin e kutikulave të trajnimit për pastrim të parave** për Akademinë e Drejtësisë dhe trajnimin e trajnerëve;
  - Tax Justice Network, Kosovo profile on IFF Geographic risks - Geographic risks for Illicit Financial Flows: Risk Profile Report Kosovo (GIZ & Tax Justice Network).

### Mbështetja nga Misioni i OSBE në Kosovë

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për të forcuar kapacitetet e Njësisë për Inteligjencë Financiare, Misioni i OSBE-së në Kosovë ofroi mbështetje për NJIF-K me pajisje të IT-së duke dhuruar 10 kompjuterë laptop dhe 10 kompjuterë tabletë për të ndihmuar zyrtarët e NJIF-it të analizojnë në mënyrë efektive të dhënat dhe

raporte, përfshirë raportet e transaksioneve të dyshimta që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.



Nga data 6-7 Korrik 2021, Misioni i OSBE-së në Kosovë sipas planifikimit për vitin 2021 ka organizuar një trajnim 2 ditor në Prishtinë, mbi luftimin e financimit të terrorizmit për përfaqësues nga NjIF, Policia e Kosovës (Drejtoria Kundër Terrorizmit dhe Drejtoria e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit), Prokurorinë Speciale, Gjykata Themelore (Departamentit Special). Trajnimi do të mundësojë pjesëmarrësve avancimin e njohurive në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me objektivat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023. Trajnimi ka mbuluar seancat për burimet e informatave, roli i NJIF-it, menaxhimi i rasteve, parandalimi i shpërdorimit të organizatave jo-profitabile për financim të terrorizmit, luftëtarët e huaj terrorist, dhe metoda të reja të transaksioneve.

Misioni i OSCE ka mbështetur NJIF-K në kursin e specializuar me certifikim ndërkombëtar për pastrim të parave, CAMS – Certified Anti-Money Laundering Specialist. Katër (4) zyrtarë të NJIF-K do të përfitojnë nga ky kurs ndërkombëtar.

Me datë 26 Maj 2021 është organizuar një takim njëditorë për 20 zyrtarë të fushës nga organizatat qeveritare dhe ato të shoqërisë civile të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ky takim ka për qëllim që të mundësojë shkëmbimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Po ashtu, ky takim do t'iu ofrojë pjesëmarrësve një vështrim më të thellë dhe më gjithëpërfshirës në temat dhe fushat e veçanta kundër korrupsionit dhe praktikave të pajtueshmërisë sikurse janë integriteti i organizatës, vlerësimi i rrezikut për korrupsion si dhe korniza dhe praktikat ligjore mbi pajtueshmërinë në fushën e luftimit të korrupsionit.

### [Mbështetja nga Ambasada e SHBA dhe Britanisë së Madhe dhe Programet regjionale](#)

Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë ka mbështetur NJIF-K me softuer të specializuar për analiza të inteligjencës financiare.

Ky aplikacion do të ndihmojë përdoruesit e NJIF-K të lidhin pikat, duke mundësuar identifikimin e krimeve të rënda, mashtrimet dhe rastet komplekse, në mënyrë më efektive.

Nga data 13 deri 17 Dhjetor 2021, një zyrtar i NJIF-K ka marrë pjesë në trajnimin "Anticorruption Series: Financial Investigations Course" i mbajtur në Budapest Hungari. Ky program trajnimi është mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Prishtinë.



## KAPITULLI VII - BUXHETI, FORCIMI I KAPACITETEVE

NjIF-K do të vazhdojë projektet të cilat janë duke u zhvilluar në përmirësimin dhe ngritjen e sistemit të TI-së dhe të zhvillimit të bazave të të dhënave, procedurat e brendshme dhe të jashtme të NjIF-K, ngritjen e vazhdueshme të bashkëpunimit me subjektet raportuese dhe vetëdijesimit të tyre rreth obligimeve ligjore mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ngritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare (agjencitë tjera homologe) si dhe vazhdimin e plotësimit të infrastrukturës ligjore (hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e dokumenteve strategjike dhe akteve tjera nënligjore) në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe evropiane sa i përket kësaj fushe.

Sa i përket obligimeve ndërkombëtare, NjIF-K është anëtare me të drejta të plota e EGMONT Grupës dhe nga ka edhe obligime shtesë financiare të cilat ndërlidhem me anëtarësimin vjetor, sistemin elektronik të shkëmbimit të informatave Egmont Secure Web (ESW), si dhe pjesëmarrje në takimet e rregullta dhe plenare. NjIF-K, po ashtu në kuadër të obligimeve të saj financiare ka kontratën ndërkombëtare me Zyrën e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimeve (UNODC) për sistemin goAML i cili është një softuer i specializuar dhe sofistikuar për Njësitë e Inteligjencës Financiar në botë, i cili shfrytëzohet edhe nga NjIF-K.

## BUXHETI DHE PROKURIMI

Ligji Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 ka përcaktuar shumat e lejuara dhe ka venë në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës për NjIF-K shumën prej 467,515 Euro.

Gjendja aktuale e buxhetit në NJIF-K mundëson përmbushjen e nevojave primare në realizimin dhe përmbushjen e mandatit të parashikuara me ligj.

Shpenzimi i këtij buxheti është paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të konsoliduar në kuadër të pasqyrave financiare të MF, dhe lidhur me buxhetin e NjIF-K, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

NjIF-K për vitin 2021 ka arritur të ketë një menaxhim dhe kontroll të mirë, duke përmbushur objektivat kryesore të planifikuara, përkundër rrethanave pandemie të krijuara gjatë vitit 2021.

NjIF-K pas auditimit nga auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit lidhur me sistemin e menaxhimit të kontrollit të brendshëm financiar sipas raportit për vitin 2021, ka pasur vetëm një rekomandim për përmirësim, i cili është përmbushur në tërësi.

Andaj, kjo nënkupton se NjIF-K ka arritur të menaxhojë sistemin e menaxhimit të kontrollit të brendshëm financiar në mënyrë të kënaqshme.

Menaxhimi financiar brenda organizatës është në pajtim me udhëzimet e përcaktuara në Rregullën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Manualin e Procedurave të MFK-së që ka ekzistuar për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2021 dhe deri në datën e aprovimit të raporteve dhe llogarive vjetore.

Gjatë vitit 2021, buxheti i realizuar nga NJIF-K ka qenë në vlerë totale prej 405,884 euro. Bazuar në


ndarjen fillestare të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike, gjatë tërë viti 2021 ka arritur shkallën e realizimit 87%.

NjIF-K bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT ka buxhetin e vet i cili sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit dhe vendosë në mënyrë të pavarur për shfrytëzim të buxhetit, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Zyra për Buxhet dhe Financa e NjIF-K, veprimtarinë e vetë e kryen bazuar në Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar) dhe ofron mbështetje profesionale në lëminë e planifikimit të buxhetit, Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, Planit të Rrjedhës së Parasë dhe Përgatit Pasqyrat Financiare Vjetore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Njësisë për Inteligjencë Financiare (NjIF-K), sipas Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i është ndarë shuma në vlerë 467,515 Euro.

Ndarja e shpenzimeve sipas nënkategorive ekonomike ishte realizuar si në vijim:



Grafiku 18: Ndarja e shpenzimeve sipas nënkategorive ekonomike 2017-2021

Kategoritë Ekonomike	Buxheti 2021	Buxheti i shpenzuar	
	ndarja fillestare	realizimi	Realizimi %
	1	2	3
Paga dhe mëditje	264,904	229,157	87%
Mallra dhe shërbime	161,136	156,165	97%
Shpenzimet komunale	11,475	7,112	62%
Shpenzime kapitale	30,000	13,450	45%
<b>Gjithsej</b>	<b>467,515</b>	<b>405,884</b>	<b>87%</b>

Tabela 16: Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2021

## Prokurimi Publik

Sa i përket procedurave të prokurimit publik këto procedura zhvillohen nga MF bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 ku është shtuar neni 21/A, ku kërkohet që me qëllim të ekonomizimit të aktivitetit të prokurimit, Ministria përkatëse kryen procedurat e prokurimit të agjencive të pavarura që kanë më pak se pesëdhjetë (50) punonjës.

Procedura e prokurimit publik në NjIF-K zhvillohet si në vijim:

*Në rastin e prokurimit kemi zyrtarin e prokurimit në NjIF-K i cili i inicion kërkesat e prokurimit për NjIF-K, bazuar në planin e prokurimit të NjIF-K dhe i adreson tutje kërkesat tek zyra e prokurimit publik në MF.*


*MF publikon tenderin sipas kërkesës së NjIF-K, kurse në procesin e hapjes dhe vlerësimit komisionet krijohen nga MF në përbërje nga zyrtarët e të dy institucioneve.*

*Tutje, të gjitha procedurat e tjera zhvillohen nga MF deri në menaxhimin e kontratës e cila bëhet nga NjIF-K.*

## Burimet njerëzore & Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K

Gjatë vitit 2021, struktura organizative e NJIF-K ka pësuar ndryshim të vogël, në numër dhe strukturë. Të punësuarit në NJIF-K janë 20 zyrtarë, një më pak se vitin 2020. Megjithatë, për t'u përballur me efektivitet me këtë fenomen nevojitet ngritje e kapaciteteve të stafit dhe resurseve. Në ndërkohë për vitin 2022 është miratuar një pozitë për stafin profesional në NJIF-K.

Strukturën e NJIF-K në kontekstin gjinorë, 33% e përbëjnë gjinia femërore, përderisa 67% janë meshkuj.



Grafiku 19: Struktura gjinore në NJIF-K

Për të përmirësuar shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin operacional në NjIF-K janë të angazhuar katër (4) zyrtar ndërlidhës nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, një nga

Dogana e Kosovës, një nga Policia e Kosovës, një nga ATK dhe një nga AKI.

Bazuar në Rregulloren nr. 01/2018 për organizimin e brendshëm në Njësinë për Inteligjencë Financiare e cila përcakton strukturën organizative si dhe organizimin e brendshëm të Njësisë për Inteligjencë Financiare, Struktura organizative e NJIF-K është si vijon:

- Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K
- Drejtori i NJIF-K, si dhe
- Sektorët

Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K përbëhet nga:

- Kryetari dhe anëtarët e Bordit Mbikëqyrës; dhe
- Sekretari i Bordit Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K bën koordinimin e politikave në nivel shtetëror për PPP/LFT-në në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe palët e interesuara relevante. Bordi miraton buxhetin dhe strukturën e NJIF-K, emëron Drejtorin e NJIF dhe shqyrton raportet vjetore të NJIF-K.

Bordi është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sigurimin e pavarësisë së NJIF-K dhe nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në asnjë mënyrë në çështjet operative të NJIF-K dhe nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimimi kundrejt NJIF-K-së.


Në vitin 2021, Bordi i NJIF-K ka mbajtur dy takime.

Zyra e Drejtorit të NJIF-K përbëhet nga:

- Drejtori i NJIF-K
- Zëvendës Drejtori i NJIF-K; dhe
- Personeli mbështetës

Sektorët e NJIF-K, janë si në vijim:

- Sektori i Operativës dhe Analizës
- Sektori për Pajtueshmëri dhe Inspektim
- Sektori për çështje Ligjor dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Sektori për Teknologji Informativ dhe Administrimit të Bazës së të Dhënave
- Sektori për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.



Grafiku 20: Struktura organizative

Edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar progresi në avancimin e Sistemit të Teknologjisë Informative, duke pasur si Objektivë rritjen e kualitetit të Inteligjencës dhe efikasitetin e Analizave.

Pavarësisht pandemisë së COVID 19 u shënuan edhe avancime në Sistemin e Raportimit përmes goAML duke arritur progres në rritjen e kualitetit të dhënave të cilat raportohen në NJIF-K.

Bashkëpunimi me Banka dhe Subjekte tjera raportuese ka rezultuar me përmirësim të kënaqshëm të kualitetit të raportimit.

Pajisjet e IT-së (llaptop dhe tablet) të pranuar si donacion nga OSBE kanë ngritur dukshëm kapacitetet analitike të NJIF-K.

U futën në raportim elektronik përmes sistemit elektronik goAML shumë entitete të reja raportuese (Auto Sallone, Noterë, Avokatë etj).



## KAPITULLI VIII - PRIORITETET STRATEGJIKE

Drejtimi dhe mbikëqyrja e Njesisë për Inteligjencë Financiare realizohet nëpërmjet: një sistemi të mirëfilltë të menaxhimit të performancës dhe instrumenteve specifik të drejtimit dhe mbikëqyrjes.

NJIF-K harton çdo vit planin vjetor të performancës. Plani për performancën e NJIF-K përmban kornizën logjike e cila përcakton objektivat, produktet, rezultatet dhe aktivitetet.

Objektivat që NJIF-K synon ti arrijë brenda periudhës të cilën e mbulon plani hartohen duke përcaktuar objektiva të cilat janë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të afatizuara. Objektivat adresojnë problemet dhe shkaqet e tyre të cilat janë hasur gjatë punës për zbatimin e mandatit të institucionit.

Prioritetet Strategjike dhe objektivat e planit të performancës së NJIF-K në nivel institucional përcaktohen në pajtim me prioritetet dhe objektivat afatmesme të Ministrisë dhe të Qeverisë, prej vlerësimit të gjithëmbarshtëm të vendit në fushën e PPP/LFT, planeve të veprimit të strategjive kombëtare, vlerësimit të rreziqeve kombëtare dhe sektoriale, PKZMSA, ERA, buxhetit dhe raporteve dhe dokumenteve tjerë që janë në interes për NJIF-K.

## PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K

Plani i performancës së NJIF-K për vitin 2021, është hartuar bazuar në Rregulloren (QRK) NR. 03/2020 për performancën e agjencive.

Plani i performancës dhe resurseve 2021 bazohet në 5 Prioritete/objektiva kryesore strategjike të NJIF-K për vitin 2021, të cilat janë paraqitur siç vijon:


- Prioriteti Strategjik I: Politikat dhe koordinimi vendor për PPP/LFT-në
- Prioriteti Strategjik II: Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe Masat parandaluese
- Prioriteti Strategjik III: Përmirësimi i aftësive të brendshme të NjIF-it për operativë dhe analiza
- Prioriteti Strategjik IV: Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar
- Prioriteti Strategjik V: Forcimi i kapaciteteve të NjIF-K

Produktet dhe rezultatet specifike për t'u arritur brenda vitit janë treguesit e performancës të cilët tregojnë qartë se cilat produkte dhe rezultate synohet të arrihen gjatë vitit që mbulon planin. Treguesit jenë të lidhur me objektivat e planit dhe matin progresin në arritjen e objektivave. Treguesit hartohen në nivel të objektivave dhe aktiviteteve. Treguesit përmbajnë edhe pikat referente për gjendjen aktuale dhe caqet që duhet të arrihen deri në fund të vitit.

NjIF-K monitoron progresin drejt arritjes së prioriteteve strategjike përmes objektivave specifike dhe llogari-dhënëse, të cilat implementohen duke u bazuar në planet e veprimit. Suksesi i institucionit vlerësohet duke përdorur indikatorët kyç të performancës.

Rezultatet e performancës (% Pajtueshmëria me Treguesit dhe % Pajtueshmëria me rezultat) kundrejt kriterit të produktit (Indikatorit matës (#,% 0-5, 0-10, Po [1]-Jo[0] dhe Plani Indikativ) evidentohen nga arritjet dhe rezultatet e raportuara në vitin 2021, në përputhje me Planin e Performancës të aprovuar 2020-2022.

Treguesit e matjes janë përdorur për matjen e rezultatit të përgjithshëm për masën përkatëse të performancës:



## Strategjitë Kombëtare dhe Planet e Veprimit për PPP/LFT

Plani Strategjik dhe Operacional i Qeverisë përcakton objektivat për NJIF-K si në vijim:

- Luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes zbatimit të rritur të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare

- Ngritja e kapaciteteve në NJIF përmes krijimit të një ekipi të veçantë apo njësi organizative në NJIF-K për zhvillimin e analizave strategjike. Trajnimet, Punëtorit dhe Konferencat e realizuara
- Zgjerimi i gamës së vlershmit të rrezikut sektorial
- Zhvillimi i legjislacionit në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit


Programi i Kosovës për Reforma në Ekonomi 2021-2023 në Prioritetin: I “Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit” ka përcaktuar si objektivë:1.1.c Intensifikimi i luftimit të krimit të organizuar, përmes rritjes së bashkëpunimit dypalësh me Shtetet Anëtare të BE-së (përfshirë përdorimin e Ekipeve të Përbashkëta Hetimore) në luftimin e shpëlarjes së parave, dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të armëve të zjarrit, me tregues:

- Numri i MM-ve të nënshkruar me NJIF-et e huaja (Shtetet Anëtare të BE-së)
- Numri i kërkesave për informata të pranuar prej NJIF-eve të vendeve të BE-së
- Numri i kërkesave për informata të dërguara tek NJIF-eve të huaja
- Numri I Raporteve/informacioneve spontane të pranuar nga NJIF-K, dhe
- Numri I Raporteve/informacioneve spontane të dërguara tek FIU e vendeve të BE-së


Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës në Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2019-2023 është bazuar në Planin e Veprimit. Është udhërrëfyes që duhet të përcjellët në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike. Plani i Veprimit përfshin gjithsej 71 veprime konkrete, nga të cilat NJIF-K është institucioni udhëheqës dhe mbështetës në gjithsej 12 veprime.

Bazuar në raportin vjetor 2019-2021 të zbatimit të strategjisë kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë jo-formale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023, të publikuar në vitin 2021, progresi i përgjithshëm në zbatimin e aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2019-2020 ka qenë mbi 50%.



Sa i përket zbatimit të gjitha veprimeve të Planit të Veprimit, në të cilat NJIF-K është institucioni udhëheqës dhe mbështetës, thuajse të gjitha aktivitetet e planifikuara për t’u zbatuar gjatë vitit 2021, 2020 dhe 2019, janë zbatuar ose janë në proces të implementimit, dhe vetëm një aktivitet nuk është zbatuar ende.





Planifikimi strategjik për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë, bazohet në menaxhimin e rrezikut, me qëllim që institucionet përkatëse kombëtare të jenë në gjendje të menaxhojnë dhe të kontrollojnë aktivitetet e tyre, në lidhje me rreziqet e mundshme në të ardhmen.

NJIF është pjesëmarrëse aktive dhe ka kontribuar në vazhdimësi në implementimin dhe rishikimin e Strategjive tjera Kombëtare dhe planeve të punës, duke përfshirë:

- Zbatimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA)
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizmit 2018-2022

- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2017-2022
- Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve 2018-2022
- Programi Qeveritar 2017-2021 - Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për Vitin 2021
- Zbatimi i konkluzioneve të Samitit të Londrës dhe Procesit të Berlinit.

Në Matricën e veprimeve afatshkurtra të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), NJIF-K është i përfshirë në dy kapituj: Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit dhe Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria.

## LISTA E SHKURTESAVE

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
LFT	Luftimi i Financimit të Terrorizmit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
AK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKI	Agjencia e Kosovës për inteligjencë
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPCJF	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (brenda PK)
DK	Dogana e Kosovës
DKT	Drejtoria kundër Terrorizmit – (brenda PK)
DRNOJQ	Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF/TFVF	Task Forca e Veprimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FT	Financimi i Terrorizmit
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
IMF	Institucion Mikrofinanciar
IPA	Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (i Komisionit Evropian)
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KiE	Këshilli i Evropës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje e mirëkuptimit
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OJQ	Organizatë joqeveritare

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONK	Oda e Noterëve të Kosovës
PECK	Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë”
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i parave
PSO	Procedura Standarde të Operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NJIF-it)
RKSOKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh)
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
SHKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës
TI	Teknologjia Informative
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër krimit dhe drogave
VRK	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale

## Shtojca 1

Tabela e mëposhtme pasqyron pjesëmarrjen në trajnime/punëtori//konferenca/vizita për vitin 2021:

Trajnim/Punëtori/Vizitë	Organizatori	Vendi	Numri i pjesëmarrësve
Tracing Illicit Financial Flows-A public&Private Approach	UNDP	Online	1
Handling Politically Exposed Persons as Clients, Identifying Suspicious Clients and Activity, and Money Laundering Typologies - Best practices from the Private and Public Sectors	UNDP	Online	9
Pamje në Raportet e SIMFK	IKAP	Online	1
Trajnuesit e te Drejtës Komerçiale	Akademia e Drejtësisë-USAID	Online	1
Strategic Analysis coaching webinars I, II, III, IV	UNDP - PECK III	Online	10
Anti-Corruption and Model Law - Executive Policy and Development Symposium on Transnational Organized Crime (MASTER)	ILEA, Budapest, Hungary	Online	1
Free Movement of Capital		Online	2
Kodi Etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në Shërbimin Civil	IKAP	Online	1
goAML – International User Group Meeting	UNODC	Online	2
Investigation, prosecution and return of assets related to money laundering and illicit financial flows	GIZ	Prishtine	6
Cryptocurrencies money laundering schemes	UNDP	Online	8
Non-profit organizations and risk assessment-engagement and lessons learned for effective implementation	European Center for not-for-profit law	Online	1
International Conference on Advancing Beneficial Ownership Transparency	Council of Europe's Horizontal Facility for the Western Balkans	Online	1
International Asset Recovery	Cepol	Online	1
Zbatim në praktikë i Ligjit për qasjen në dokumente Publike	Agjencia per infirmim dhe privatësi	Prishtine	1
Financial Investigation training	GIZ	Tiranë	1
Microsoft Excel 2013	IKAP	Prishtine	1
Prezentimi i tipologjive per FT	PECK III	Online	10
Money Laundering course	Cepol	Online	1

ECOFEL Information Sharing between FIUs, Supervisory Authorities and LEAs Workshop Participation	ECOFEL	Online	1
Regional Workshop on Investigation and Prosecution of Legal Entities for Corruption and Money Laundering Offences	Council of Europe's Horizontal Facility for the Western Balkans	Online	2
Francophone's FIUs Financial Cooperation Forum 2021, Monaco	Monaco FIU	Monaco	2
Dialogu multi-akterë për qasjen e OJQ-ve në shërbime financiare dhe ndikim në punën e OJQ-ve		Prishtine	1
Mbrojta e të dhënave të klasifikuara	AKI	Prishtine	4
Keqpërdorimi kriminal i personave juridik dhe marrëveshjeve ligjore - Identifikimi i Pronësisë përfituese	PECK III	Pejë	4
Trajnimit e Avancuar për hetimin e Narkotikëve	Policia e Kosovës	Prishtine	1

Tabela 17: Aktivitetet e trajnimeve/punëtorive/ konferenca /vizitat nga stafi i NJIF-K për vitin 2021